

1 E enjte, 18 janar 2023

2 [Konferencë përgatitore për gjykim]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.

7 Mirë se erdhët, të gjithë.

8 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar.

10 Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar
11 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
12 Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani ju lutem
14 palëve të prezantohen si dhe ekipin e tyre, duke filluar me
15 Prokurorinë.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar. Nga ZPS-
17 ja sot kemi Ward Ferdinandusse, Alan Tieger, Nathan Quick,
18 Deborah Mayer, Julie Mann dhe unë jam Matt Halling.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
20 z. Halling.

21 Tani i lutem Mbrojtjes sipas rendit të të akuzuarve në
22 aktakuzë.

23 Z. Kehoe, në fakt ju u çuat në këmbë.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Gregory Kehoe.

25 Kam Luca Misetiç, Sophie Menegon dhe Bonnie Johnston dhe

1 paraqesim këtu z. President Thaçi.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Emerson, për Mbrojtjen e Veselit.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më falni, se nuk i njoh shumë
5 mirë këto butonat këtu. Ndjesë për këtë.

6 Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Unë jam Ben Emerson në
7 emër të Kadri Veselit, kam me vete këtu edhe znjsh. Annie
8 o'Reilly dhe z. Andrew Strong si bashkëavokat.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 z. Emerson.

11 Z. Roberts, ju lutem, për Mbrojtjen e Selimit.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
13 Jam Geoffrey Roberts në emër të z. Selimi, së bashku me mua,
14 në të djathtën time, z. Eric Tully, znjsh. Natasha Ryzhenko,
15 Znjs. Rudina Jasini dhe në të majtë kam Riva Gjeçaj dhe Sara
16 Isufin. Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
18 z. Roberts.

19 Z. Roberts, ju lutem, i urojmë edhe një shërim sa më të
20 shpejtë z. Young dhe ju lutem përcillni të falat tona.

21 Znj. Alagendra, për z. Krasniqi.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
23 Gjykatës. Jam këtu në emër të z. Krasniqi. Këtu kam bashkë me
24 vete edhe z. Aidan Ellis, bashkëavokat; z. Victor Baiesu,
25 bashkëavokat; po ashtu kemi edhe Mentor Beqirin me

1 videolidhje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
3 znj. Alagendra.

4 z. Laws, tashmë fjala për ju.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Jam Simon Laws,
6 përfaqësoj viktimat në këtë çështje, së bashku me ndihmësen
7 time Maria Radziejowska.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
9 Laws.

10 Tashmë nga Zyra Administrative, ju lutem.

11 Z. ROCHE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Jam Ralph Roche
12 edhe paraqitem këtu në emër të Zyrës Administrative.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
14 procesverbal, dua gjithashtu të them që kemi të akuzuarit në
15 sallën e gjyqit.

16 Për procesverbal, unë jam Charles Smith, Kryegjykatësi
17 për këtë çështje gjyqësore. Kolegët, gjykatësit e mi koleg,
18 kemi në të majtë z. Guenaël Mettraux; në të djathtë, Christoph
19 Barthe, edhe më tej në të djathtë, Fergal Gaynor.

20 Tani dua t'ju them që nuk do të hyjmë shumë në detaje dhe
21 është humbje kohe që të prezantohemi çdo herë që kemi seanca.
22 Ju lutem, vetëm njoftoni Zyrën Administrative nëse do të
23 merrni pjesë apo jo.

24 Duke filluar që sot dua t'ju them që - më falni - sot do
25 të kemi një pushim në orën 11.00. Do të rifillojmë në 11.30,

1 pastaj në orën 13.00 do të kemi pushimin e drekës. Do të
2 mblidhemi në orën 14.30 dhe do të vazhdojmë deri në orën
3 16.00. E kemi rezervuar sallën dhe për nesër nëse është e
4 nevojshme për të përfunduar të gjitha pikat. Megjithatë, ne
5 shpresojmë që nuk do të jetë e nevojshme. Megjithatë, unë
6 dëshiroj t'ju pyes nëse do të jetë e nevojshme. Megjithatë në
7 qoftë se është, sigurisht, që ne e kemi sallën.

8 Ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve të garantohet që të
9 gjitha parashtrimet të jenë sa më të shkurtra në temë, në
10 mënyrë që këtë seancë ta kemi sa më efikase.

11 Sikurse e thamë në tetor, konferenca për përgatitjen e
12 çështjes që kishim parashikuar për sot, ne synojmë t'u
13 kërkojmë palëve disa aspekte procedurale, po dhe disa më në
14 thelb, sa i takon planifikimit të shpejtë të fillimit të
15 gjykimit.

16 Do të fillojmë me disa pyetje procedurale. Pyetja e parë
17 është për ZPS-në, do t'i kaloj të katra pyetjet. Dhe nëse
18 dikush nga Mbrojtja do t'i përgjigjet, kundërpërgjigjet më
19 saktë, përgjigjeve të ZPS-së, sigurisht, lirisht, mund ta
20 bëjnë këtë.

21 ZPS-ja a e ka përfunduar nxjerrjen e provave që propozon
22 të prezantojë në gjyq dhe ZPS-ja a na konfirmon se lista e
23 dëshmitarëve të provëzuar dhe provat materiale tashmë janë të
24 përfunduara?

25 Z. Halling.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

2 Në varësi të masave mbrojtëse, gjithçka është nxjerrë.
3 Nuk kemi ndonjë kërkesë plotësuese për të shtuar dëshmitarë në
4 këtë pikë. Jemi duke përgatitur një kërkesë për të shtuar
5 provë materiale, që shpresojmë ta dorëzojmë deri në fund të
6 muajit, si dhe do të përfshijmë aty edhe arsyet e vlefshme pse
7 e kemi kërkuar këtë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
9 z. Halling.

10 Sa i takon provave aktuale ekzistuese, a mund të na
11 konfirmoni [që] ZPS-ja e ka përfunduar shqyrtimin e tyre edhe
12 i ka nxjerrë të gjitha provat shfajësuese dhe a i ka nxjerrë
13 Mbrojtjes të gjitha materialet që ju duhet [të] ishin nxjerrë?
14 Nuk është nevoja t'jua kujtojmë që e keni për detyrim sipas
15 rregullores, që janë në vazhdimësi e sipër kuptohet, ju jeni
16 në dijeni që e keni detyrim. Ne duam të dimë rreth materialeve
17 që keni në zotërimin tuaj dhe jo çfarë mund të vij në
18 zotërimin tuaj në të ardhmen.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

20 Në varësi të proceseve sikurse kemi paraqitur në raportin
21 tonë për nxjerrjen e materialeve, që është parashtrimi i
22 protokolluar 1019, kemi përfunduar shqyrtimin e materialeve
23 shfajësuese për të gjitha materialet deri në fillim të kësaj
24 jave. Do të ketë nxjerrje të tjera të materialeve në bazë të
25 rregullit 103, për arsyet që ju përmendët dhe për arsyet që

1 kemi dhënë në raport.

2 Jemi në hapat përfundimtarë për të përgatitur një paketë
3 tjetër sipas rregullit 103, që do ta nxjerrim këtë javë dhe ka
4 mesatarisht 15 materiale në të. Dhe do të ketë edhe një
5 kërkesë për masa mbrojtëse për disa prej materialeve që
6 ndodhen në të. Është e vetmja paketë sipas rregullit 103 që
7 përgatisim aktualisht. Dhe është thuajse gati.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është ZPS-ja
9 gati të dorëzojë kërkesën në bazë të rregullit 153 dhe 154 për
10 40 dëshmitarët e parë deri më 7 shkurt, sikurse është
11 propozuar?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Sikurse e vumë në dukje dhe në
13 parashtrimin tonë, nuk kemi asnjë dëshmitar të rregullit 153
14 për 40 të parët.

15 Për rregullin 154 mund ta bëjmë për 12 dëshmitarët e parë
16 deri më 7 shkurt. Për të gjithë numrin e plotë të dëshmitarëve
17 dëshirojmë të themi që duam të përgatisim diçka më afër datës.

18 Do të bëjmë një kërkesë më të konsoliduar pas grupit të
19 parë të 40 dëshmitarëve. Sikurse mund ta shihni nga propozimet
20 tona, ne do të jemi në gjendje t'ju dorëzojmë këto kërkesa për
21 dëshmitarët e tre muajve të tjerë në të njëjtën kohë që do të
22 dorëzohet dhe materiali në përputhje me paragrafin 73 të
23 urdhrit paraprak për zhvillimin e procedurave.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Më falni, një moment.

1 Tani dua t'ia jap fjalën Mbrojtjes në fakt. Ju jeni gati
2 t'i përgjigjeni deri më 14 shkurt, 12, me sa kuptojmë 12 të
3 parave?

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Varet. Janë shumë voluminoze këto
5 materiale. Janë shumë të detajuara. Është e vështirë të dimë
6 sesa prova materiale janë për secilin [nga] 154 dëshmitarët.
7 Edhe duke folur me kolegët e mi e dimë që ka me qindra prova
8 materiale me shumë të ngjarë. Për 12 të parat, do kërkonim dy
9 javë kohë në mënyrë që t'i shqyrtojmë dhe t'u përgjigjemi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I drejtohem
11 Prokurorisë. E dini ju sa prova materiale keni në këtë paketë
12 që po thoni?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt, nuk i di saktësisht
14 provat materiale, por për 12 dëshmitarët e parë, ka të paktën
15 me dhjetëra prova materiale shoqëruese.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mendoni se
17 është mjaftueshëm dy javë për t'u përgjigjur?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim për t'u
19 përgjigjur. E rëndësishme është që të kemi vendime në bazë të
20 rregullit 154 paraprakisht mjaftueshëm para gjykimit sepse
21 ndikon dhe në përgatitjen për dëshmitarët tanë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Z. Emmerson, ka ndonjë gjë të shtoni?

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Asgjë për të shtuar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, z.

1 Roberts, ndonjë gjë për të shtuar?

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

4 Alagendra, ndonjë gjë?

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Asgjë, ne e mbështesim

6 kërkesën.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Do ta marrim parasysh, do të marrim një vendim më vonë gjatë

9 seancës së sotme.

10 Atëherë, gjithashtu nuk presim kundërpërgjigje. Vetëm një

11 përgjigje për secilin nga ju.

12 ZPS-ja është gati të dorëzojë kërkesën për të gjithë

13 dëshmitarët që kanë humbur jetën, që kanë vdekur deri më 1

14 mars?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do ju jap një përgjigje të

16 përgjithshme për ata që kanë vdekur dhe për ata që s'janë të

17 disponueshëm. Po. Kërkesa e parë mund të dorëzohet brenda asaj

18 date dhe do të jetë më shumë se gjysma e dëshmitarëve të

19 rregullit 155 që kemi atë listë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po në listën

21 me 40 dëshmitarët?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt, për rregullin 155 do jetë

23 e gjithë lista. Ne gjithashtu mendojmë se do të dorëzojmë më

24 shumë se një kërkesë. Ne kemi bërë një kërkesë. Po përpigëmi

25 të përshpejtojmë disa informacione që na lidhen, që vërtetojnë

1 vdekjen e tyre apo disa dëshmitarë që nuk kanë mundësi të
2 marrin pjesë për arsye shëndetësore, na duhen disa raporte
3 mjekësore. Mendojmë, që do t'i dorëzojmë brenda asaj date. Të
4 paktën më shumë se gjysmën do ta dorëzojmë brenda asaj date.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e dini se
6 në ç'fazë të procedurave do të jeni në gjendje të na i jepni
7 këto të dhëna?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Për momentin që të dorëzojmë
9 kërkesën sipas rregullit 51 [sipas përkthimit], do të jetë
10 edhe momenti që do të paraqesim ato.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ju deri
12 tani mendoni të dorëzoni vetëm gjysëm deri në çfarë date?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Gjysma e parë do të dorëzohet
14 brenda datës 1 mars 2023, sikurse e përmendët dhe ju.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Kehoe, doni të përgjigjeni?

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Unë mendoj
18 se janë rreth 32 dëshmitarë të rregullit 155, nëse e kujtoj
19 siç duhet. Disa prej dëshmitarëve, po ashtu ka qenë në çështje
20 të tjera, janë trajtuar nga gjykatës të tjerë si, për
21 shembull, tek TPNJ-ja. Tani duhet të shikojmë 46.000 faqe
22 dokumente që do të trajtojmë brenda datës 1 shkurt, plus kemi
23 dhe redaktimet që do hiqen nga deklaratat e dëshmitarëve, pra,
24 është një kohë e konsiderueshme kjo.

25 Është e vështirë deri në 1 mars 2023 që t'i shqyrtojmë të

1 gjitha këto materiale. Po flasim për --

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po flasim për
3 16.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, 16 fillimisht. Po kërkoj një
5 kohë të konsiderueshme. Në fakt, kjo është në përputhje me
6 gjithë punën tjetër që bëjnë ekipet e Mbrojtjes.

7 Prandaj për t'u përgjigjur, na duhet të paktën një muaj
8 t'u përgjigjemi 155 dokumenteve që do të nxirren deri në 1
9 mars.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurish që
11 çështja duhet të jetë në vazhdimësi. Dhe do keni mundësi që të
12 ngrini mundësi që të ngrini kundërshtime përgjatë procesit.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, në fakt, unë do t'i kërkoja
14 Gjykatësit, që këto të mos jepen të gjitha pa paraqitur ne
15 kundërshtimet tona, për të parë se çfarë provash mund të
16 pranohen dhe çfarë jo.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A duhet të
18 hamendësojë me të drejtë se edhe ekipet e tjera të Mbrojtjes
19 kanë të njëjtën pikëpamje?

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përgjigja është kështu: Sigurisht
21 që ne e kemi merak për këtë kategori dëshmitarësh që do të
22 japin prova drejtpërdrejtë, sigurisht, me sjelljet dhe
23 veprimet. Dhe detyrimi për nxjerrjen e materialeve nga ana e
24 Prokurorisë, sigurisht, që është shumë i lartë që të garantojnë
25 që Mbrojtja t'i ketë të gjitha materialet që janë të

1 rëndësishme sidomos sa i takon besueshmërisë së dëshmitarëve
2 që do të paraqitet në gjyq.

3 Ju më parë folët për periudhën kohore, në fakt, mund të
4 ketë pyetje që duam t'i ngremë, debate juridike sa i takon
5 detyrimeve të Prokurorisë për nxjerrjen e materialeve,
6 dëshmitar për dëshmitar. Nuk është se po nxjerr fiks një
7 përfundim.

8 Sigurisht duhet ta shikojmë në vazhdimësi, duhet të
9 shikojmë deklaratat në mënyrë që të dalim në përfundimet tona.

10 Pra, unë nuk e di, a duhet bërë para se t'i paraqesin
11 materialet apo përgjatë procesit. Është çështje e menaxhimit
12 të kohës kjo. Për sa kohë nuk anashkalohet detyrimi për
13 nxjerrjen e materialeve.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria a
15 e pranon një vonesë prej 30 ditësh përpara se të paraqesin
16 deklaratat sipas rregullit 155? Pra, me fjalë të tjera, a ju
17 pengon ju në paraqitjen e provave?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk na ndërpret.

19 Po, për sqarim, ne synojmë t'i paraqesim ato në momentin
20 që do parashtrojmë dhe kërkesën. Në qoftë se duhet një muaj
21 për t'u përgjigjur mua më duket shumë. Mund të kërkojnë,
22 sigurisht, shtyrje të afatit për përgjigjen duke parë edhe
23 dëshmitarët specifikë që do të përfshihen, megjithatë e lemë
24 në dorën e Trupit Gjykses.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase a keni

1 menduar të ndani listën që doni të parashtroni?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt e kemi të gjithë listën,
3 mund t'i bëjmë një njoftim Mbrojtjes.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po na afrohet
5 data e fillimit të gjykimit.

6 Sugjeroj që ta bëni në këtë formë. Të paktën njoftoni
7 Mbrojtjen kush janë sepse mbase e zgjidh në pjesë të punës.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po, mund ta bëjmë këtë gjë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
10 Gaynor ka një pyetje.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Një pyetje të shpejtë.
12 Mbrojtja ngriti çështjet e nxjerrjes së materialeve. Krahas
13 certifikatave të vdekjes dhe raporteve mjekësore, a ka ndonjë
14 problem për të nxjerrjen e materialeve? Besoj se kanë dalë --
15 besoj se i janë dhënë Mbrojtjes deklaratat e dëshmitarëve që
16 kanë vdekur.

17 Z. HALLING: [Përkthim] E saktë, i nderuar Gjykatës. Nuk
18 parashikojmë që të kemi asnjë problem për nxjerrjen e
19 materialeve për këtë grupim të parë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts, a
21 keni ndonjë gjë që doni të thoni në lidhje me këtë?

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Asgjë të veçantë në lidhje me
23 këtë. Sikurse me të drejtë e thatë ju, situata e këtyre
24 dëshmitarëve nuk ndryshon. Prandaj nuk e kuptoj pse qenka e
25 vështirë për Prokurorinë të na e thotë paraprakisht këtë

1 informacion, sepse na jep mundësinë që të përgatitemi dhe të
2 kuptojmë a na duhet a s'na duhet më shumë kohë. Po mendoj, se
3 një muaj është e nevojshme për t'u përgjigjur, duke marrë
4 parasysh edhe detyrimet e tjera që kemi ne.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Alagendra.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mbështesim kërkesën për një
8 muaj, afatin njëmuajor.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani, pyetja
10 e pestë. Palët a synojnë të kërkojnë njoftim të fakteve të
11 gjykuara në bazë të rregullit 157(2) të Rregullores; dhe, nëse
12 po, kur do të jenë gati t'i përgatisin këto kërkesa?

13 Fillimisht Prokuroria.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Po përgatisim një kërkesë për
15 faktet e gjykuara. Mendojmë që do të jetë gati para fillimit
16 të gjyqimit. Për të gjitha faktet e gjykuara, në mënyrë që të
17 jemi në gjendje të evidentojmë para gjyqimit cilat kanë qenë
18 zhvillimet për gjatë procesit, sepse, pastaj, në varësi të
19 proceseve mund të jetë nevoja të dorëzojmë të tjera.

20 Në varësi të rezultatit në çështjen Mustafa, mund të
21 dorëzojmë një mocion të mëtejshëm për faktet e gjykuara në
22 varësi të akuzave dhe vendit të krimit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. Kehoe.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Ne do të jemi në pozicion, besoj

1 së bashku, dorëzojmë një njoftim për faktet e gjykuara. Ka dhe
2 një aspekt tjetër të rëndësishëm që del në paragrafin
3 7(i), (ii), në varësi, që është natyra e konfliktit të
4 armatosur, periudha. Ne mund t'i diskutojmë kur të vijë
5 momenti, po ne do të jemi në gjendje që të dorëzojmë këtë
6 njoftim para fillimit të gjykimit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë do pyesja
8 pastaj mund të ketë një përgjigje të konsoliduar, po ju u
9 përgjigjët për këtë.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Në fakt, ne po e diskutojmë. Për
11 pjesën më të madhe, kolegët pajtohen cilat do të jenë faktet e
12 gjykuara. Do ketë disa përjashtime, po besoj që në të njëjtën
13 faqe.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pajtohem.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pajtohem.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

19 Alagendra.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Pajtohem.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani,

22 rregulli 117 i Rregullores së Procedurës dhe e Provave

23 parashikon që para se të dëgjojmë palët, Trupi Gjykses do të

24 përcaktojë një afat kohor për parashtrimin e mocioneve që janë

25 dorëzuar para fillimit të gjykimit. Këto mocione dorëzuar para

1 fillimit të gjykimit përndryshe nuk do të shqyrtohen, në qoftë
2 se nuk ka dhe arsye të vlefshme.

3 Arsyeja për këtë është sepse të gjitha duhet të jenë
4 shqyrtuar në kohë të mjaftueshme përpara gjykimit dhe nuk do
5 të lejohen më vonë gjatë procesit të gjykimit përveç nëse ka
6 arsye të vlefshme.

7 Kjo nuk duhet parë si një ftesë për të dorëzuar mocione
8 para Trupit Gjykses sepse, sigurish, burimet janë të vogla,
9 kuptohet, për të gjitha palët, prandaj duhet të përpiqemi të
10 fokusohemi në atë çka është më e domosdoshme për një
11 përgatitje efikase.

12 Rregulli 117 duhet kuptuar në mënyrë të atillë si një
13 ftesë për të ngritur ç'është e vërtetë që janë shqetësuese dhe
14 kanë ndikim të drejtpërdrejtë në gjyq dhe të cilat Trupi
15 Gjykses duhet t'i zgjidhë tashmë dhe jo në një moment të
16 mëvonshëm sidomos në qoftë se çështja në fjalë njihet nga
17 palët.

18 Edhe njëherë, kjo nuk është një ftesë për të ngritur
19 problematika përpara se të jenë ngritur konkretisht probleme
20 të tilla, si pyetja sa i takon pranueshmërisë së provave të
21 cilat do të trajtohen, sigurisht, kur të kemi një çështje
22 konkrete që do të ngrihet.

23 Ne mbështetemi në gjykimin tuaj të mirë, në përvojën tuaj
24 të mirë si avokat nëse vërtetë duhet ngritur një çështje tani
25 apo në një moment të më vonshëm.

1 Ndonjë prej palëve a parashikon të dorëzojë një mocion
2 apo kërkesë të tillë?

3 Z. Prokuror.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Tani, me sa kuptoj unë, Trupi
5 Gjykues interesohet të kuptojë mocione që kërkojnë zgjidhje
6 para fillimit të gjykimit.

7 Mund të themi se nga ana jonë nuk kemi asnjë mocion të
8 kësaj natyre. Ajo që mund të them unë, për datën e 15 shkurtit
9 që është propozuar në urdhrin për këtë seancë, për sa kohë
10 data mbetet 1 marsi, nuk na jep kohë, në fakt, që të përgati -
11 - nuk jep kohë të mjaftueshme që të merren vendime përveçse
12 nëse shkurtohen afatet përkatëse. Mbase mund ta afrojmë datën
13 në shkurt në qoftë se i mbetemi datës së 1 marsit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Okej, do të
15 shohim si do të vijojë kjo punë.

16 Z. Kehoe.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë fillimisht dua të flas për
18 mocionin, që ne e kemi bërë në bazë të deponimeve që kemi
19 marrë nga dëshmitarë. E kemi dorëzuar këtë mocion më 9 janar.
20 Dhe kjo në fakt lidhet me argumentet që sapo ngritët ju. Pra,
21 ky mocion është ende në pritje. Nuk e di nëse është pjesë e
22 kategorisë 117, por po e ngre në këtë moment para Trupit
23 Gjykues që të jeni në dijeni.

24 Një gjë tjetër që duam të ngremë ne - që lidhet me
25 paragrafin 7(i), (ii) - është mundësia për bigëzimin e çështjes

1 mbi konfliktin e armatosur. E kemi diskutuar këtë me njëri-
2 tjetrin, e kemi njoftuar, në fakt, që duam ta ngremë këtë me
3 ZPS-në si aspekt. Do ta diskutojmë këtë kur të shqyrtojmë më
4 në hollësi paragrafin 7. Po edhe njëherë, ky është një mocion
5 i 116/117 që ne do ta dorëzojmë para Trupit Gjykses dhe do
6 kemi nevojë të diskutojmë hollësi në këtë pikë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Z. Emerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Një aspekt më i përgjithshëm në
10 fakt, që lidhet me pjesën e gjyqimit të nderuar Gjykatës, ka
11 të bëjë me debatin juridik në vazhdimësi tek sa po i afrohem
12 datës së fillimit të gjyqit, jemi në fazën që do të marrim
13 materialet e paredaktuara, përfshirë edhe disa dëshmitarë të
14 tjetër, për të cilët do të nevojitet një hetim më i
15 hollësishëm dhe do të ketë kërkesa për nxjerrje materiale.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të flas
17 për këtë për një moment.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë në varësi të diskutimit,
19 do të diskutojë çështjet e tjera lidhur me këtë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Krahas çështjes që ngriti z.
22 Kehoe, që e mbështesim absolutisht, nuk ka asnjë gjë që duam
23 të ngremë lidhur me 117 në këtë pikë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
25 Znj. Alagenda.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk ka asnjë
2 çështje tjetër nga ana jonë përkrah atyre që u ngritën tashmë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
4 z. Ellis.

5 Z. Laws, a doni të parashtroni ndonjë gjë nga ana juaj?

6 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk ka asgjë nga ana jonë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja tjetër
8 është për Zyrën Administrative.

9 Z. Roche, a parashikon Zyra Administrative që të ketë
10 persona të tjerë që të bëjnë kërkesë për të qenë pjesëmarrës
11 në proces si viktimat?

12 Z. ROCHE: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

13 Aktualisht Zyra Administrative nuk ka asnjë indicie për
14 kërkesa të tjera për persona që dëshirojnë të jenë viktimat
15 pjesëmarrëse në këtë proces. Askush nuk na ka kontaktuar
16 konkretisht as individualisht, as me anë të përfaqësimit.

17 Kanë qenë tetë kërkesa që janë marrë që kur është
18 transmetuar çështja para Trupit Gjykues më 15 dhjetor 2022 dhe
19 Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave është duke i shqyrtuar këto.

20 Mund të ketë kërkesa të tjera në të ardhmen. Dhe në rast
21 se Trupi Gjykues vendos të caktojë një afat për dorëzimin e
22 kërkesave, sigurisht, që mendojmë që kjo do të nxisë dorëzimin
23 e kërkesave të tjera.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt, jemi
25 në dijeni që duhet të vendosim një afat për dorëzimin e tyre.

1 Mendoni ju se 15 shkurti është një datë e përshtatshme nga
2 pikëpamja e Zyrës Administrative?

3 Z. ROCHE: [Përkthim] Ju faleminderit, të nderuar
4 Gjykatës. Nuk mendojmë se do të shkaktojë ndonjë vështirësi
5 kjo. Sidomos, se ne nuk jemi në dijeni të ndonjë kërkesë që
6 është në pritje e sipër.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a
8 doni të thoni ndonjë gjë ju në lidhje me këtë?

9 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë në lidhje me këtë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
11 nga Prokuroria apo nga Mbrojtja lidhur me këtë pikë që sapo
12 ngritëm?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Asgjë, i nderuar Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani i
15 kthehem palëve dhe pjesëmarrësve. A ka dalë ndonjë gjë, ndonjë
16 çështje e re, qysh nga takimi ynë i fundit që pengon synimin
17 tonë për të filluar gjyqin më 1 mars 2023 sikurse është
18 planifikuar?

19 Z. Halling.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, asnjë gjë nga ana jonë. Por
21 dua të shpjegoj pozicionin tonë, ne jemi të njëjtit pozicion
22 si herën e fundit, ne jemi gati që ky gjykim të fillojë në
23 mars dhe jemi gati të fillojë më 1 mars.

24 E di që Mbrojtja propozoi një datë në fund të marsit në
25 seancën e fundit. Të jemi të qartë, nuk e kundërshtojmë ne,

1 por ne duam që të paktën gjyqi të fillojë këtë muaj, që të
2 fillojë më së paku dhe pastaj të kemi prezantimin e provave.

3 Sigurisht edhe për organizimin logjistik me dëshmitarët
4 duhet të dimë me saktësi kur të fillojë gjyqi dhe ta dimë në
5 kohë të mjaftueshme paraprakisht.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, ne jemi gati të fillojmë më 1
8 mars, por kolegët kanë disa komente të mëtejshme në lidhje me
9 këtë, kështu që do jua jap fjalën përkatëse secilit prej tyre.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Parimisht, nuk ka asnjë arsye pse
12 nuk duhet të fillojmë më 1 mars.

13 Duhet të vlerësojmë, e vlerësojmë sigurisht edhe
14 pajtohen, besoj, kolegët e mi sigurisht, që ne kemi një
15 periudhë të jashtëzakonshme intensive pune këtë muaj që mbase
16 do na krijojë disa vështirësi teknike në fakt.

17 Po në bashkëpunim me Zyrën Administrative kemi pasur disa
18 vështirësi për pikën e kontaktit në Kosovë, për shembull. Pra,
19 disa nga këto aspekte mund të na krijojnë disa pengesa, po unë
20 nuk i parashikoj dot këto, po nuk shoh asnjë pengesë që të
21 fillojmë më 1 mars.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

24 Sigurisht që incidenti që ndodhi seancën e fundit ka
25 ndikim në përgatitjen tonë.

1 Ne jemi në dijeni të situatës, sigurisht. Dhe duam të
2 fillojmë gjykimin sa më shpejt që të jetë e mundur. Dhe
3 sigurisht, idealisht, do të donim të fillonim më 1 mars.
4 Megjithatë sikurse jeni në dijeni, ne jemi duke u përpjekur të
5 trajtojmë pasojat e asaj që na ndodhi herën e fundit dhe
6 sigurisht do përpiqemi të fillojmë më 1 mars apo sa më shpejt
7 pranë asaj date, megjithatë ka disa gjëra që mund të pengojnë
8 përgatitjen tonë.

9 Mund të ketë disa pengesa që mund të na krijojë një
10 vonesë të vogël, po kjo varet shumë nga identiteti i 12
11 dëshmitarëve të parë që do të japin dëshmi. Disa sugjerime që
12 mund të bëjmë ne është që të ketë një pushim pas deklaratave
13 hyrëse. E ngritëm dhe në seancën e fundit të njëjtën gjë për
14 ecurinë e çështjes. Nëse mund të fillojmë më 1 dhe 2 mars me
15 deklaratat hyrëse, idealisht të bëjmë një ndërprerje një javë
16 a 10 ditë.

17 Së dyti të kemi pastaj një ndërprerje 2-javore pas grupit
18 të parë trejavor dhe jo një javë. Në mënyrë që të përgatitemi
19 siç duhet për shkak se nuk do të kemi të pranishëm z. Young
20 gjatë kësaj periudhe.

21 Dhe, së treti edhe këtë, sigurisht, mund ta ngremë në
22 komunikim me Prokurorinë, do kërkojmë që për 12 dëshmitarët e
23 parë të mos ketë dëshmitarë që të flasin për pretendime
24 konkrete ndaj z. Selimi, të ngritura kundër z. Selimi. Sepse
25 kjo do të ketë ndikim pastaj në përgatitjen tonë.

1 Tani, unë nuk e di nëse Prokuroria ka ndonjë prej këtyre
2 dëshmitarëve në listë, në grupin e parë të 12 dëshmitarëve.
3 Fakti që dëshmitari mund ta ketë takuar z. Selimi gjatë
4 konfliktit apo thjesht ka pasur komunikim me atë nuk është
5 relevante. Por nëse ngrenë akuza konkrete do të jetë pak
6 problematike për ne.

7 Po i ngre këto pika si çështje të mundshme që mund t'i
8 diskutojnë me ne. Duam të fillojmë sa më herët. Z. Selimi do
9 të fillojë sa më herët, do të garantojmë të jemi të
10 përgatitur, sigurisht i vetmi problem është që dëshmitarët të
11 cilët duhet t'i kemi pjesë të kundrapyetjeve nuk i bëjmë dot
12 këto qysh në fillim.

13 Ne presim të marrim listën e 12 dëshmitarëve të parë
14 brenda 1 shkurtit dhe deklaratat e paredaktuara të këtyre
15 dëshmitarëve dhe, sigurisht, do të bëjmë kërkesa më konkrete,
16 më të shtjelluara në ato momente.

17 Por në këto rrethana kaq mund të them.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
19 Do t'i mbajmë parasysh.

20 Znj. Alagendra, keni gjë për të shtuar?

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Nëse më lejoni të nderuar Gjykatës
22 në këtë pikë. Aktualisht, ne po përgatitemi për fjalët hyrëse
23 në fillim të marsit, më datën 1 mars. Dua të them, sidoqoftë,
24 që mbetemi në pritje të nxjerrjes së dokumenteve që do të
25 vijjnë nga fundi i këtij muaji. Është përmendur shifra prej

1 47.000 faqesh në këtë sallë gjyqi. Dhe kur të shohim këtë
2 material, kur të shohim sesa punë duhet dhe cilët janë
3 dëshmitarët e parë, atëherë ne do të jemi në gjendje që të
4 vijmë e t'ju themi, të nderuar Gjykatës, që materiali është
5 shumë voluminoz dhe aq i madh sa nuk kalojmë dot në dëgjimin e
6 dëshmitarëve menjëherë.

7 Ne, sigurisht, që e mbështesim sugjerimin e z. Roberts,
8 që të ketë një ndërprerje midis fjalëve hyrëse dhe arritjes së
9 dëshmitarëve të parë, pasi kështu do të na mundësohet
10 përgatitja. Por këtë do ta dimë vetëm pasi të kemi materialet
11 e nxjerra nga pala tjetër.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çdo gjë që
13 është thënë dhe i kthehem asaj që thatë ju, z. Emerson, që të
14 gjitha këto ilustrojnë faktin që ne do të kemi një muaj shumë
15 intensiv në shkurt dhe të gjithë duhet të bashkëpunojnë njëri
16 me tjetrin, të shkëmbejnë informatat e duhura, ato që mund të
17 shkëmbehen. Ne nuk presim që ju të dorëzoni armët dhe në qoftë
18 se nuk e kuptoni se çfarë nënkuptohet kjo pyesni z. Kehoe.
19 Por, duhet të ekzistojë një lloj bashkëpunimi midis
20 Prokurorisë dhe palës mbrojtëse dhe meqë e keni marrë vendimin
21 edhe duhet diskutuar.

22 Dhe pasi kështu jam mësuar unë ta drejtoj këtë çështje.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po jap një shembull, ne kemi
24 shkëmbyer në mënyrë shumë të frytshme mendimet që [REDAKTUAR].
25 [REDAKTUAR].

1 [REDAKTUAR]. Pasi, nëse ju kujtohet, një
2 nga pyetjet, një nga çështjet që na ndante ne si palë në këtë
3 çështje ishte kjo dhe të dy palët kemi rënë dakord që do të
4 ishte e parakohshme që t'i kërkonim Trupit Gjykses që të
5 nxjerrë urdhër mbi këtë çështje për ta shtyrë këtë pasi nuk na
6 janë nxjerrë materialet e duhura.

7 Ne po bëjmë atë që është e mundur për të gjetur zgjidhje
8 praktike ndaj çështjeve që lindin për të zgjidhur problemet
9 midis palëve pa kaluar kjo në çështje të gjykuara.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Siç thatë ju, z. Roberts dhe siç jua thashë herën e
12 kaluar, ne jemi këtu në të njëjtën sallë gjyqi dhe një veprim
13 i cili zgjat jo një javë po dy javë ndikon në një gjyq tjetër

14 Dhe unë po përpiqem këtu që të bëj një plan pune për një
15 vit të tërë për juve, me qëllim që të gjithë ne ta kemi të
16 qartë se çfarë, cili është programi i punës, kjo e ndihmon
17 edhe Trupin Gjykses që ta qartësojë kalendarin e punës.

18 Megjithatë do t'i marrim parasysh të gjitha kërkesat që ju i
19 keni bërë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Roberts, më kanë
21 kërkuar që t'ju bëj një sugjerim juve, që ju t'i tregoni ZPS-
22 së cilët janë dëshmitarët për të cilët keni shqetësime me
23 qëllim që ju të kuptoni nëse këta do të jenë mes 12
24 dëshmitarëve të parë dhe kjo do të çojë në diskutimin midis
25 jush dhe ZPS-së për të parë nëse ka mundësi që ata të shfaqen

1 në një moment tjetër të mëvonshëm.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
3 Unë mund t'i lexoj pseudonimet tani me qëllim që Prokuroria
4 dhe palët e tjera ta kenë të qartë. Përndryshe, do ta bëj këtë
5 *inter partes* me Prokurorinë dhe shpresoj që të gjejmë një
6 zgjidhje të përbashkët.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të ishte më mirë që
8 këtë ta bëni njëri me tjetrin *inter partes*.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,
10 ju përmendët një pseudonim para pak kohësh. Është ky
11 dëshmitari për të cilin jeni të shqetësuar dhe e përmendët
12 edhe javën e kaluar?

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne nuk e kemi
15 pasur pseudonimin më parë.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndoshta ZPS-ja mendon që ky
17 pseudonim nuk duhet të jetë në seancë të hapur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, këtë e
19 keni bërë.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, përmenda një emër.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A doni që kjo
22 të fshihet?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po, po e bëjmë këtë kërkesë tani.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

25 A është kjo përgjigja që deshët, i nderuar Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. E
2 kuptojmë kërkesën tuaj dhe nuk po argumentojmë kundër, por
3 duhet që para ditës së premte, të bëni një mocion përpara për
4 ta shpjeguar se çfarë dëshironi.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e bëjmë derisa të kemi parë
6 dokumentin. Ajo me të cilin kemi rënë dakord mes palëve është
7 që ta shtyjmë diskutimin e kësaj çështjeje derisa të shohim se
8 çfarë materialesh kanë ato në zotërim dhe sa kohë do të
9 zgjasin hetimet lidhur me këtë. Dhe pasi të kemi marrë të
10 gjitha këto informacione, atëherë do të jemi në gjendje të
11 bëjmë mocionet e duhura.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord. Dhe
13 ne atëherë po tërhiqemi dhe po presim që të na dërgoni
14 mocionet përkatëse.

15 Okej, z. Laws, ju e keni fjalën.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Për sa i përket gatishmërisë për të
17 filluar gjyqin. Në emër të viktimave, ne nuk kërkojmë që të
18 ketë vonesa në këtë gjykim dhe nuk kërkojmë që të shtyhet data
19 nga 1 marsi, por duhet të mos harrohet që kjo është e ndryshme
20 nga ajo që do të thuhet që jemi të gatshëm për të filluar
21 gjykimin, pasi, siç e dini i nderuar Gjykatës, priten të
22 shqyrtohen 84 kërkesa të viktimave. Dhe duhet të zgjidhet kjo
23 çështje përpara se të fillojë gjykimi, duam që të takohemi me
24 ta për të kuptuar se cila është situata e tyre, me qëllim që
25 t'i përfaqësojmë në mënyrën e duhur.

1 Ndoshta kjo gjë nuk do të jetë e mundur dhe do ta bëjmë
2 këtë gjatë procesit të gjyimit. Pra, nuk po kërkojmë që të
3 shtyhet data, por duam t'i tregojmë Trupit Gjykes se, në
4 kuptimin e ngushtë të fjalës, ne mund të mos jemi krejt të
5 gatshëm për ta filluar gjyqin më datën 1 mars.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
7 të pamundurën për t'i përshpejtuar këto kërkesa pasi të na
8 jenë paraqitur.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Unë besoj që ato janë paraqitur
10 tashmë, me përjashtim të tetë, të cilat nuk kanë ardhur akoma.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vlerësimi i
12 tyre do të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Jam i
13 sigurt për këtë.

14 Dua të di se kur dëshironi që të mbajmë konferencën
15 përgatitore të Prokurorit të Specializuar, do të kërkonim se
16 cila do të ishte data më e përshtatshme, duke e mbajtur
17 parasysh që nuk mund të jetë përpara datës 1 shkurt, pasi
18 gjyqi duhet të fillojë brenda 30 ditëve, në bazë të
19 rregullores që kemi.

20 Dhe po kërkoj komentet tuaja, së pari nga Prokuroria.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Siç e thatë ju, i nderuar
22 Gjykatës, mbasi të paraqitet data e gjyqit atëherë duhet të
23 mbahet konferenca e Prokurorit të Specializuar dy javë
24 përpara.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe,

1 është e përshtatshme kjo datë?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. E vetmja gjë që do të diskutohet
3 në këtë konferencë janë kundërshtimet ndaj provave materiale
4 të cilat duhen nxjerrë. Unë besoj që ju e keni dhënë një
5 urdhër gojor që do të kemi 48 orë pas nxjerrjes që dokumentit
6 për të bërë kundërshtimet tona dhe ne kemi bërë një mocion
7 para Trupit Gjykses që ky afat kohor të zgjatet. Ne nuk duam
8 që ta mbajmë këtë konferencë përpara se të na jepet koha më e
9 zgjeruar për t'u përgjigjur.

10 Është një numër shumë i madh provash materiale dhe ne po
11 përgatitemi që të kemi një pozicion të përbashkët, jam i
12 sigurt që Trupi Gjykses do të dëshirojë që t'i ketë të gjitha
13 këto prova materiale. Dhe i kërkojmë Trupit Gjykses që ta
14 mbajë parasysh kërkesën tonë për ta shtyrë afatin në të cilin
15 ne duhet të bëjmë këtë mocion.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dy javë është krejtësisht e
18 përshtatshme për ne.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Roberts.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe për ne parimisht është i
22 pranueshëm periudha 2-javore.

23 Një nga çështjet që mund të lindin është problemi i
24 hetimeve që kanë të bëjnë me disa hetime tona të cilat do të
25 vijjnë pasi të kemi marrë dokumentet e përdaktuara. Dhe ne na

1 duhet të bëjmë disa hetime të duhura dhe prandaj kjo mund të
2 ndikojë në datën që kemi parasysh.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'jua
4 japim datën gjatë ditës së sotme.

5 Znj. Alagendra.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dy javë janë të përshtatshme.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I kthehem
8 tani palës mbrojtëse. A dëshironi që të mos ushtroni të
9 drejtën që të lexohet aktakuza gjatë hapjes së çështjes?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria, a
15 jeni dakord që të mos lexohet aktakuza?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kisha
18 përshtypjen që përgjigjet do të ishin pozitive në këtë
19 drejtim.

20 Unë besoj që Prokuroria do të bëjë një fjalë hyrëse?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ne po parashikojmë që kjo të
22 zgjasë gjashtë orë, që do të thotë, që do të mbahet gjithë
23 ditën e parë dhe pjesën e parë ditës së dytë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a
25 dëshironi të bëni një fjalë hyrëse?

1 Z. LAWS: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, dhe nuk do
2 të zgjasë më shumë se 45 minuta.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja
4 është e gatshme të na tregojë nëse janë të gatshëm që të bëjnë
5 një fjalë hyrëse pas ZPS-së apo do ta bëjnë këtë në fund të
6 paraqitjes së argumenteve të ZPS-së apo nuk do të bëjnë fare?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Në emër të z. Thaçi, ne do të japim
8 fjalën hyrëse pas deklaratës së ZPS-së dhe do të zgjasë tre
9 deri në katër orë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
11 z. Emmerson.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne e rezervojmë pozitën deri në
13 ato momente, vetëm mund të them tani që: Nëse do të bëjmë një
14 fjalë hyrëse, ajo do të zgjasë më pak se 45 minuta.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ne synojmë që të bëjmë një fjalë
17 hyrëse në të njëjtën kohë pas palëve të tjera të Mbrojtjes.
18 Dhe kjo do të zgjasë maksimumi një orë, i nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

20 Alagendra .

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne do të bëjmë një deklaratë
22 hyrëse, të nderuar Gjykatës dhe vlerësojmë se do të zgjasë një
23 orë e gjysëm.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Menjëherë pas
25 Prokurorisë?

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Menjëherë pas.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të
3 na duhet ndoshta që të parashikojmë një seancë dy ditore për
4 këtë, me qëllim që ta përfundojmë në kohën e duhur pa një
5 trysni të madhe.

6 Siç është shpjeguar më parë, ne synojmë që ta
7 shfrytëzojmë këtë sallë gjyqi sa më shumë që të jetë e mundur
8 në periudhën në vazhdim duke pasur parasysh që një trup tjetër
9 gjykues do të gjykojë një çështje tjetër penale. Ne kemi vetëm
10 një sallë gjyqi.

11 Dhe unë do të sugjeroja që ta bëjmë këtë: Katër ditë në
12 javë, nga e hëna deri të enjten, pesë orë në ditë; tre javë me
13 radhë duke u ndjekur me një javë pa seancë gjyqësore; dhe
14 pastaj tre javë në vazhdimësi dhe pastaj me dy javë pushim;
15 dhe këto të alternohen. Ditët do të fillojnë në orën 9.00 dhe
16 do të vazhdojë deri në orën 11.00; do të marrim një pushim
17 gjysëm orësh; pastaj seanca e dytë nga 11.30 me një pushim për
18 drekë një orë e gjysëm; dhe pastaj seanca e tretë nga 14.30
19 deri në orën 16.00.

20 A keni ndonjë koment për të bërë lidhur me këtë program
21 seancash Prokuroria?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nga pala jonë
23 ne do të dëshirojmë që të fillonim në orën 9.30, siç e kemi
24 bërë sot. Dhe, në qoftë se ju dëshironi që kjo të zgjasë pesë
25 orë në ditë, ta shtyjmë me seancën e fundit. Përndryshe nuk

1 kemi komente të tjera.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
3 arsye për këtë çështje?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Ka disa çështje, probleme të cilat
5 lindin nga fundi i ditës, i ndihmon palët që të kemi një
6 dritare të vogël paradite që ta diskutojmë këtë. Kjo do të
7 ndihmojë po kështu edhe Zyrën Administrative dhe përkthyesit.
8 Ka edhe një numër të personelit të ZPS-së të cilët kanë
9 angazhimet e tyre në mëngjes nga ora 8.00 e mëngjesit dhe do
10 të na ndihmonte kjo periudhë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta mbajmë
12 këtë parasysh.

13 Z. Kehoe.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim me
15 propozimin.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A doni të
17 komentoni lidhur me kërkesën e Prokurorisë?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kam qëndrim
19 për të mbajtur me këtë. Nuk ka rëndësi.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Desha t'jua
21 jepja mundësinë.

22 Z. Emmerson.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pa dhënë ndonjë kundërshtim të
24 madh, do të mbështesnim qëndrimin e Trupit Gjykes që do të na
25 lejonte ne si palë Mbrojtëse që të shikonim, të analizonim

1 gjatë zhvillimit të ditës dhe të merrnim udhëzime nga klienti
2 ynë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shqetësimi
4 ynë i vetëm ishte që t'ju jepej mundësia juve që të
5 përgatiteshit në fund të ditës për ditën pasuese.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ne nuk kemi ndonjë qëndrim. Ose
7 9.00 ose 9.30 është e njëjtë për ne, s'ka problem.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
9 Alagendra.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe ne jemi dakord me të dy
11 propozimet 9.00 ose 9.30.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo nuk do të
13 ketë tani nevojë për pyetje apo përgjigje, por dua të them që
14 vazhdojmë të jemi të shqetësuar lidhur me kohën që ka
15 vlerësuar Prokuroria për çështjen e saj.

16 Ne i vlerësojmë përpjekjet e ZPS-së deri më tani për të
17 zvogëluar këtë afat kohor por e inkurajojmë ZPS-në që të
18 shqyrtojë plotësisht nevojën për të shkurtuar paraqitjen e
19 argumenteve të saj dhe për të shfrytëzuar të gjithë
20 instrumentet procedurale që ka në dispozicion për të bërë të
21 mundur që gjyqi të jetë i drejtë por edhe i shpejtë.

22 Ne sa e kemi treguar vizionin tonë lidhur me ditët e
23 seancave për periudhën në vazhdim dhe në qoftë se kjo
24 funksionon si duhet, do të dëgjohen dëshmi për 600 orë një vit
25 dhe, mund të them, që nga përvoja ime që asgjë nuk është

1 perfektë dhe gjyqi mund të zgjasë më shumë sesa shpresojmë.

2 Pasi është angazhim mjaft i madh për të pasur 600 orë brenda
3 një viti. Megjithëkëtë, ky është synimi që kemi.

4 Ne kemi autoritetin sipas rregullit 118 për të marrë masa
5 për të ulur numrin e dëshmitarëve, të akuzave, të vendit të
6 krimeve dhe për t'i kërkuar ZPS-së që ta zvogëlojë periudhën e
7 pyetjeve paraprake që u bën dëshmitarëve. Ne do t'i
8 shfrytëzojmë të gjitha këto mundësi dhe po e përsëris që do ta
9 bëjmë këtë vetëm në qoftë se vlerësojmë se ZPS-ja nuk po
10 shfrytëzon si duhet kohën që ka në dispozicion.

11 Megjithëkëtë, i kërkojmë ZPS-së që t'i shqyrtojë edhe
12 njëherë argumentet e saj për të ulur numrin e dëshmitarëve që
13 përsëriten dhe për të përzgjedhur vendet e krimit, incidentet
14 apo vendet e paraburgimit, të cilat janë përfaqësuesit e
15 krimeve të paraqitura në aktakuzë. Pritet që ZPS-ja do ta bëjë
16 këtë jo vetëm para se të fillojë gjykimi, por gjatë gjithë
17 gjykimit dhe për ta vlerësuar nevojën, justifikimin për të
18 thirrur një dëshmitar për të dëshmuar dhe për kohën në
19 dispozicion për secilin prej këtyre dëshmitarëve. Trupi
20 Gjykues do ta vlerësojë mënyrën sesi i paraqisni ju argumentet
21 tuaja dhe do të vendosë nëse ka ndonjë nevojë që ne të
22 ndërhyjmë për të bërë të mundur që procedura të përshpejtohet.

23 Ne presim që ky dëshmitar të ketë -- që gjyqi të jetë i
24 gjatë dhe ne vlerësojmë që periudha pesë vjeçare që
25 parashikohet ka shqetësime të mëdha.

1 Dhe po të isha unë një dëshmitar, do të bëja vetë këto
2 programime dhe të mos prisja për Trupin Gjykses. Por mos bëni
3 gabimin, ne do të bëjmë shkurtimet në qoftë se mendojmë se kjo
4 është e domosdoshme për të mbrojtur të drejtën e të akuzuarve
5 dhe për të bërë të mundur që këto procese penale të mos
6 zgjaten tej mase.

7 Ne do ta diskutojmë këtë me Prokurorinë dhe do të
8 kërkojmë që të na jepet një parashikim i ditëve të gjyqit dhe
9 të pyetjes së dëshmitarëve të tyre.

10 Ne kërkojmë të besojmë që ne mendojmë të -- vazhdojmë të
11 besojmë që ekziston mundësia e diskutimeve mes palëve për të
12 identifikuar ato fusha të cilat janë të diskutueshme dhe të
13 cilat nuk janë. Megjithëkëtë, e gjithë kjo duhet bërë me
14 synimin që të eliminohen dëshmitë e panevojshme.

15 I kërkoj Prokurorisë që të na tregojë numrin e
16 dëshmitarëve që duan të thërrasin. Përpara na kanë dhënë një
17 listë prej 323. A doni t'i thërrisni të gjithë këta 323 vetë,
18 apo thjesht po jepni edhe emrin e dëshmitarëve potencial të
19 cilët do të thirren për të ardhur këtu nëse është e nevojshme?

20 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, për sa i
21 përket pyetjes së fundit. Është një numër dëshmitarësh në këtë
22 listë, të cilët janë të rregullit 153 dhe 155, të cilët nuk
23 synojmë që t'i thërrasim që të vijnë këtu por do të
24 mbështetemi në dëshminë e tyre. Jo të gjithë këta dëshmitarë
25 do të vijnë këtu për të dhënë dëshminë para Trupit Gjykses.

1 Dhe, në fakt, disa nuk e bëjnë dot një gjë të tillë.

2 Por ata që vijnë këtu për të dhënë dëshmi, sipas
3 rregullit 154, janë ata që janë në listë. Nuk di nëse këtë po
4 e bëjmë për t'u treguar të kujdesshëm, por është e mundur që
5 gjatë gjyqit dëshmitarët mund të paraqesin dëshmi që ta bëjnë
6 të panevojshme paraqitjen e dëshmitarëve të mëvonshëm,
7 megjithatë, kjo do të varet nga zhvillimet gjatë gjykimit.

8 Gjëja e fundit që doja të shtoja, të nderuar Gjykatës,
9 është që udhëzimet tuaja dhe pritshmëritë që keni për ne janë
10 të qarta. Siç e tha Gjykatësi Barthe në seancën e muajit të
11 kaluar, ne po shikojmë dëshmitarët e rregullit 154 për të parë
12 nëse mund ta zvogëlojmë kohën që na duhet për t'i marrë ata në
13 pyetje. Në fakt edhe për 12 dëshmitarët e parë, ne po e bëjmë
14 një vlerësim të këtillë për ta ulur.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Aktualisht
16 sot, sa mendoni se do të zgjasë paraqitja e argumenteve tuaja?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Prokuroria mbetet si dhe në listën
18 e fundit, pak më shumë se 700 orë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është
20 vetëm për pyetjet që keni ju për të bërë dhe jo për
21 kundërpjetet e palës tjetër?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, kjo ashtu është.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. Kehoe, ju kërkoj ndjesë.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. A mund të them

1 diçka përpara se të kalojmë në pikën tjetër apo konferencën
2 tjetër. Dhe ka të bëjë me strukturën.

3 Prokurori, kur ai apo ajo flet mbi një incident të
4 caktuar, i grumbullon dëshmitarët.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë isha gati
6 për ta bërë këtë pyetje.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do
9 kthehem në një nga çështjet që i kemi bërë gjatë konferencës
10 së ecurisë së çështjes në dhjetor.

11 Emmerson.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Isha gjysëm i
13 ngritur për të dhe nuk e di nëse më keni parë.

14 Çështja që doja të ngrija, është që ZPS-ja ka dëgjuar
15 mesazhin e Trupit Gjykses dhe propozimi do të ishte që të
16 shkurtohet koha që ka në dispozicion ZPS-ja në marrjen e
17 pyetjeve të dëshmitarëve të rregullit 154.

18 Pyetjet që keni ngritur ju lidhur me palët, lidhur me
19 mocionin që kanë bërë në konferencën e 14 të ecurisë së
20 çështjes, të cilës do t'i kthehem. Është e qartë por po
21 përsëris që dëshmitë që paraqet ZPS-ja me dëshmitarët 154, siç
22 e kuptoj unë dhe të gjitha intervistat që kanë bërë me ta - që
23 nganjëherë bëhet fjalë për një dëshmitar që ka tetë deklaratata
24 të këtilla, deklaratata në cilat dëshmitari ka folur në mënyrë
25 të përgjithshme dhe nuk ka nënshkruar deklaratën - e kështu,

1 pra, rezultati do të ishte që periudha do të ishte shkurtuar,
2 në qoftë se pyetja bëhet, në mënyrën shumë banale, a i keni
3 treguar të vërtetën ZPS-së.

4 Megjithëkëtë, pala mbrojtëse do të duhet t'i lexojë të
5 tërë këto intervista dhe është një ekonomi e gabuar të mendosh
6 që është një prezantim i thjeshtë. Do t'i mundësojë kjo gjë
7 ZPS-së që të gjithë periudhën e saj ta shkurtojë nga 700 orët
8 e parashikuar, por për palën mbrojtëse bëhet fjalë për
9 çështjen e pyetjes dhe më duket sikur kjo gjë do të bëjë që
10 t'i takojë palës mbrojtëse që të bëjë pyetje që do i bëjë
11 Prokuroria.

12 Po e bëj këtë paralajmërim, pasi ka pasoja të cilat
13 rrjedhin nga metodologjia e shfrytëzuar deri më tani nga ZPS-
14 ja; pra, metodologjia që ta shfrytëzojë dëshminë dhe
15 intervistat e dëshmitarëve si një dokument mbi të cilin duan
16 të mbështeten për të provuar argumentet e tyre. Është një
17 dëshmitar dhe, nuk do ta përmend këtë, nuk është i mbrojtur
18 dhe po tregohem i kujdesshëm këtu në seancë të hapur, por
19 është një dëshmitar, i cili ka dhënë dëshminë në katër gjyqe
20 të mëparshme, ka bërë tetë intervista me ZPS-në, ka dhënë
21 deklaratat në një numër procesesh për proceset e tjera penale
22 ndërkombëtare, që të gjitha do të paraqiten këtu.

23 Jam i sigurt që në rastin e këtij dëshmitari ZPS-ja do të
24 kalojë një numër orësh duke theksuar ato elemente që dëshiron
25 të thotë. Dhe siç ju thashë, të nderuar Gjykatës, koha që do

1 të na duhet ne për të bërë kundërpyetjet do të jetë shumë e
2 gjerësishme pasi është një material i gjerësishëm.

3 Por, në përgjithësi, shkurtimi i afatit të kohës duke
4 ulur pyetjet kryesore të Prokurorisë së dëshmitarëve të cilët
5 më pas vijjnë me një dokumentacion të gjerësishëm e ngre barrën
6 që i bëhet palës mbrojtëse për këtë dhe për këtë është një
7 problem metodologjik. Është një nga problemet të cilat ZPS-ja
8 asnjëherë nuk është angazhuar që ta bëjë. Të gjitha çështjet
9 që ngrihen përpara Trupit Gjykes mund të ndodhë që nuk kanë
10 të bëjnë me skenën e krimit por kanë të bëjnë me çështjen e
11 koordinimit, përgjegjësisë, administrimit dhe kështu me radhë.

12 Unë po e bëj këtë koment paraparak tani, për të
13 nënvijëzuar faktin që është një situatë e ndryshme kur kemi të
14 bëjmë me një dëshmitar, për shembull, që ka një deklaratë prej
15 pesë faqesh. Ky është një dëshmitar i 154. Dhe situatës tjetër
16 me të cilën do të përballohem gjatë gjyqit dhe për të cilin
17 fola.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po. Ne
19 nuk kemi filluar ende që t'i kërkojmë palës mbrojtëse që ta
20 shkurtojë periudhën e kundërpyetjeve dhe sa është, gjë të
21 cilën do ta ngremë ndoshta pak më vonë. Por e di, e kam
22 parasysh për çfarë po flisni dhe prandaj barra tashmë i takon
23 Prokurorisë, ky është një proces ballafaques dhe ata do të
24 paraqesin argumentet e tyre siç dëshirojnë ta bëjnë këtë gjë.
25 Të njëjtën gjë do të bëjë edhe pala mbrojtëse.

1 Një nga pyetjet që bëmë në konferencën e fundit kishte të
2 bënte me strukturën e argumenteve, z. Emmerson në këtë
3 deklaratën e tij më të fundit përmendi diçka.

4 Ju na thatë që do ta informoni Trupin Gjygues më në
5 hollësi sesi do ta strukturoni këtë çështje. Tani është koha
6 që ta bëni këtë, na tregoni sesi propozoni të veproni me
7 kategori, me çështje, në mënyrë kronologjike, me bazën e
8 krimit të pretenduar. Na tregoni në mënyrë të përgjithshme se
9 çfarë do të pritët nga pala e ZPS-së gjatë paraqitjes së
10 argumenteve të tyre në këtë çështje kaq të ndërlikuar.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Ne
12 mocionin e premtës së kaluar, në paragrafin 25, të dosjes
13 F01208, e kemi paraqitur pak a shumë këtë çështje.

14 Siç e thamë në këtë parashtrim, ka një numër faktorësh që
15 i shqyrtojmë dhe ne duam që të kemi provat tona në një
16 strukturë tradicionale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYGUES SMITH: [Përkthim] Edhe një
18 herë?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ne po i japim prioritet sigurimit
20 të provave me qëllim që ta bëjmë këtë në një mënyrë
21 tradicionale, duke thirrur njerëzit që të vijnë për të
22 dëshmuar për një krim të caktuar. Kjo nuk është faktori që ne
23 po diskutojmë. Bëhet fjalë për disponueshmëri të dëshmitarëve,
24 grupimin e tyre, janë një nga të gjitha këto çështje që ne po
25 i shqyrtojmë.

1 Por, siç i kemi paraqitur në dokumente me shkrim, është
2 që argumentet tona do të jenë koherente dhe t'i lejojnë Trupit
3 Gjykses që ta ndjekë ecurinë. Prezantimi që bëhet mes një
4 skene të një krimi apo në mënyrë kronologjike nuk është
5 praktike për argumentet tona. Ne jemi të fokusuar me qëllim që
6 të gjithë dëshmitarët të dëgjohen në këtë çështje dhe të
7 luftojmë në këtë mënyrën edhe klimën e frikësimit të
8 dëshmitarëve që është aktualisht në Kosovë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a do
10 të jeni i pranishëm gjatë gjithë gjyqimit?

11 Z. LAWS: [Përkthim] Po. Ashtu synojmë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkon Gjykata komentet tona.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk prita që
15 të komentoni. Po nëse keni koment mund të vazhdoni.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Shkurtimisht.

17 Nuk e di se për çfarë po flet avokati në lidhje me
18 ndikimin publik të çështjes, sepse kjo çështje është në
19 vazhdim e sipër, ka dy vjet tani. Ne këto gjëra i kemi
20 diskutuar, çështjen e frikësimit të dëshmitarëve. Ky është një
21 faktor i parëndësishëm.

22 Se pse ne tani po largohemi nga detyra e Prokurorisë për
23 të paraqitur provat sipas një radhitje sepse, në qoftë se një
24 dëshmitar, për shembull, nuk është i disponueshëm sepse është
25 i sëmurë apo nuk ka mundësi të dëshmojë, atë e kam të qartë.

1 Por një qasje tradicionale e paraqitjes së provave sipas një
2 vendi krimi apo kronologjie e shkurton kohën dhe nuk kemi
3 nevojë të dëgjojmë, për shembull, për një dëshmitar që flet
4 për një incident në këtë moment dhe pastaj dy dëshmitarë të
5 tjerë që flasin për të njëjtin incident dy muaj më vonë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 z. Kehoe.

8 Dikush tjetër a ka për të komentuar?

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e kemi të qartë këtë që e tha
10 Prokurori në lidhje me lidhjen midis sigurisë dhe koherencës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ne nuk e
12 kemi të qartë. Por, besoj, që do të kemi një qartësim më të
13 madh kur të fillojë paraqitja e provave. Nuk e di se çfarë
14 publiciteti ka të bëjë me këtë apo frikësimi i dëshmitarëve
15 për atë punë me radhitjen apo rendin e paraqitjes së provave.

16 Me fjalë të tjera apo thënë qartë, a do t'i paraqitni
17 provat në bazë të vendit të krimit? Në bazë të kronologjisë?
18 Në çfarë mënyre do t'i paraqitni provat? A mund të na thoni?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ne po bëjmë vlerësimet e rrezikut
20 në mënyrë që të sigurohemi që të gjithë dëshmitarët mund të
21 vijjnë këtu dhe të dëgjojnë.

22 Ne çmojmë udhëzimet në lidhje me organizimin e paraqitjes
23 së provave. Mirëpo, ne kemi një farë logjike sepse e bëjmë
24 radhitjen e dëshmitarëve në mënyrën që po e bëjmë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po logjika

1 mbas kësaj a është disponueshmëria e dëshmitarëve apo diçka
2 tjetër?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Jo disponueshmëri në kuptimin se
4 kur ke kohë për të ardhë për të dhënë dëshmi, por
5 disponueshmëri në kuptimin që ne të mund ta thërrasim
6 dëshmitarin përpara se t'i ndodhë diçka atij dëshmitari apo
7 përpara se të ketë rrezik ndërhyrje ndaj tij.

8 Kur flas për parimin e publicitetit, është një faktor
9 tjetër nga faktorët tjerë. Për shembull, ne nuk do të
10 thërrasim një sërë dëshmitarësh të mbrojtur, pa pasur një farë
11 ndërprerje midis paraqitjes së atyre dëshmitarëve, sepse disa
12 dëshmitarë mund të kenë detyrime të tjera personale apo nuk
13 mund të jenë të disponueshëm në një moment kohor.

14 Pra, të gjithë këta faktorë janë marrë parasysh kur kemi
15 bërë organizimin e paraqitjes së provave.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, por
17 unë e kam për detyrë të them se prapë s'e kam të qartë sesi do
18 t'i paraqisni provat dhe se ku po shkoni me këtë metodologji.
19 Në qoftë se ju i paraqisni këto dëshmi të dëshmitarëve në
20 mënyrën që ju mendoni se është e duhur, atëherë nuk do të ketë
21 një farë strukturë koherente në paraqitjen e argumenteve tuaj.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ne jemi përpjekur që t'i
23 radhitim dëshmitarët në një mënyrë që është koherente dhe në
24 kontekstin e asaj sesi dëshmia e një dëshmitari të përshtatet
25 me gjithë kontekstin e çështjes.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta lëmë
2 këtu për momentin. Ju faleminderit.

3 Z. Ellis, urdhëroni.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] E çmoj atë që po e lëni këtë pikë
5 këtu, po e përfundoni këtu dhe mund të jetë një gjë që duhet
6 t'i kthehemi në një konferencë tjetër.

7 Unë thjesht dua të them këtë: Do të kemi në këtë çështje
8 dëshmitarë që janë ende me masa mbrojtëse dhe kur të fillojë
9 gjykimi dhe identiteti i tyre do të zbulohet vetëm 30 ditë
10 përpara dhënies së dëshmisë. Dhe, si rezultat i kësaj,
11 aktualisht, pjesë të mëdha të dëshmive të tyre janë të
12 redaktuara për Mbrojtjen.

13 Në këtë moment, si Mbrojtje, dua të di se për çfarë bëhet
14 fjalë në mënyrë që të jem në gjendje t'i bëj kundërpyetje atij
15 dëshmitari, për shembull, në qoftë se dëshmitarët në
16 deklaratat e tyre flasin për kushtet e ndalimit që lidhen me
17 dëshminë e njërit dëshmitar dhe të tjetrit, atëherë duam që ta
18 kemi këtë parasysh në mënyrë që t'i eliminojmë të gjitha
19 problemet në momentin e duhur.

20 Ne kemi frikë se, së pari, kundërpyetjet për ata
21 dëshmitarë nuk do të jenë efektive sepse nuk do ta kemi atë
22 pasqyrën e plotë të asaj që ka thënë dëshmitari në deklaratën
23 e vetë.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të shtoj diçka.

25 Parashtrimet e Mbrojtjes nuk synojnë që Trupi Gjykses të marrë

1 një vendim, por thjesht janë shqetësime në lidhje me atë që
2 ne, si Mbrojtje, parashikojmë se mund të jetë problematike.

3 Ne, nga pikëpamja e Mbrojtjes, themi kështu, në qoftë se
4 një dëshmitar ftohet për të dhënë dëshmi për një ndodhi për
5 shembull të një niveli ndërkombëtar apo mbas atij vjen një
6 dëshmitar që ka të bëjë me vendin e krimit dhe pas asaj vijon
7 me një dëshmitar tjetër që është ndonjë ish-anëtar i Ushtrisë
8 Çlirimtare të Kosovës, atëherë nuk do të ketë kurrfarë
9 koherence dhe kjo nuk është praktike sepse kjo do të ngrejë
10 vështirësi. Ka nevojë që Mbrojtja të jetë e aftë të përgatitet
11 në mënyrë të gjerësishme dhe gjithëpërfshirëse duke i marrë
12 parasysh të gjitha vështirësitë që mund të dalin në marrjen në
13 pyetje të atyre dëshmitarëve, për shembull, në marrjen në
14 pyetje të ndonjë personi që ka pasur rol në nivel ndërkombëtar
15 në atë kohë apo të një ish-anëtari të Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës.

17 Prandaj, kjo do ta ulë shpejtësinë e zhvillimit të
18 gjykimit. Thjesht po e bëj këtë parashikim në këtë fazë sepse
19 ekziston rreziku. Dhe dëgjova çka tha Prokurori dhe ju e bëtë
20 të qartë, i nderuar Trupi Gjykses, se do t'ia lini Prokurorisë
21 që të vendosë sesi do t'ia paraqesë provat e veta. Por, ne nuk
22 duam që kjo paraqitje e provave të jetë një mënyrë kaotike që
23 më pas do t'ia lënë Trupit Gjykses që t'ia zgjidhë të gjitha
24 ato probleme që mund të dalin nga ajo mënyrë e paraqitjes së
25 provave. Në qoftë se e shikoni edhe një herë procesverbalin e

1 konferencës përgatitore, do të shikoni se sa herë Mbrojtja ka
2 potencuar këtë aspekt.

3 Provat duhet të shikohen në një kontekst që mund të
4 artikulohet edhe në një fazë të mëvonshme.

5 Unë thjesht po e përmend këtë sepse padyshim që duhet t'i
6 kthehemi këtij problemi në të ardhmen.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhëroni, z.
8 Halling.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Në lidhje me raportet, me komentet
10 e z. Ellis, ne e kemi parasysh këtë se nxjerrja e dëshmisë së
11 një dëshmitari 30 ditë para se ai të vijë për të dhënë dëshmi
12 në Gjykatë, mund të ndikojë në përgatitjen e Mbrojtjes,
13 prandaj është edhe kjo masë e Mbrojtjes në mënyrë që të
14 mbrohet dëshmitari të cilit i janë miratuar masa mbrojtëse.

15 Dhe kjo, domethënë, varet rast pas rasti sesi do të
16 paraqiten provat.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju
18 faleminderit.

19 Në mënyrë që Prokuroria të jetë e suksesshme, ajo duhet
20 të paraqesë një diçka që është koherente dhe e kuptueshme për
21 këta katër njerëz. Dhe në qoftë se nuk është koherente,
22 atëherë paraqitja e provave nuk është e suksesshme. Dhe po i
23 bëj këto pyetje në mënyrë që të ilustrojmë shqetësimet tonë në
24 lidhje me këtë.

25 Ne presim që Prokuroria të marrë masa në lidhje me këto

1 shqetësime të Trupit Gjykses.

2 Ju faleminderit.

3 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, kam
5 edhe një pyetje për ju. Më falni që e harrova.

6 Trupi Gjykses ka marrë një kërkesë të përbashkët të datës
7 13 janar për zgjatjen e afatit ku duhet të tregohet koha që
8 parashikohet për marrjen në pyetje të 12 dëshmitarëve të parë
9 të ZPS-së dhe që kjo të tregohet në një parashtrim me shkrim
10 deri më 13 shkurt 2023.

11 Më falnin z. Laws. I kam bërë shënimet e mia gabimisht.

12 Pyetja është për Prokurorinë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Në lidhje me atë kërkesë F01204,
14 ne nuk kemi kurrfarë problemi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do ta
16 bëjmë pushimin e mëngjesit tani së shpejti. Mendoj që
17 Gjykatësi Barthe e kishte një pyetje.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju faleminderit, Gjykatës
19 Smith.

20 Më duhet sqarim nga avokati i z. Veseli, z. Emmerson, në
21 lidhje me komentet e bëra në konferencën e statusit të 8
22 shtatorit 2022 në lidhje me kundërpjetet për dëshmitarët e
23 ZPS-së sipas rregullit 153 dhe 154.

24 Z. Emmerson, Trupi Gjykses vëren se gjatë asaj konference
25 të ecurisë të 8 shtatorit 2021 [sipas përkthimit] dhe kjo

1 është në faqen e transkriptit 1512 [sipas përkthimit], rreshti
2 21 deri në faqen 1518, rreshti 1 dhe po citoj:

3 "Praktika e përgjithshme në tribunale të tjerë është që
4 kur dëshmitari vihet në dispozicion për kundërpyetje vetëm në
5 lidhje me një dokument që është dorëzuar si provë materiale në
6 vend të dëshmisë gojore, në ato raste Mbrojtjes i mundësohen
7 për afërsisht dy herë më shumë kohë se ajo që i është dhënë
8 Prokurorisë".

9 Pyetja ime, z. Emmerson, vazhdon të jetë ky qëndrimi juaj
10 apo ka ndonjë ndryshim?

11 Ju faleminderit.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju faleminderit. Ta gjej atë
13 pjesë për të cilën bëtë pyetje. Po e korrigjoj procesverbalin
14 në këtë pikë. Është në të njëjtën pjesë që sapo e lexuat, i
15 nderuar Gjykatës, ku përmendet rregulli 153 në vend të kësaj
16 duhet të jetë rregulli 154. Mirëpo kjo nuk bën ndonjë dallim
17 të madh.

18 Nga përvoja që të paktën unë kam pasur në Tribunalin
19 Penal për ish-Jugosllavinë, në qoftë se Trupi Gjykses thotë,
20 koha standarde për kundërpyetje për një dëshmitar është, të
21 themi, 30 minuta dhe ti do më shumë se 30 minuta, atëherë
22 duhet t'i bësh kërkesë Trupit Gjykses paraprakisht dhe kjo ka
23 një arsye.

24 Nuk jemi në këtë fazë në këtë procedurë, mirëpo mirë
25 është të merren këto përvoja të mëparshme parasysh, në qoftë

1 se, për shembull, në mënyrë efektive Prokuroria shkurton kohën
2 e vet për marrjen në pyetje të dëshmitarit të vet, për
3 shembull, i lexohet deklarata dhe i thuhet dëshmitarit "A
4 është kjo që e ke thënë në këtë deklaratë e vërtetë? Dhe a e
5 pranon si deklaratë tënden?" dhe dëshmitari thotë "Po",
6 atëherë Mbrojtjes i mbetet më shumë kohë për t'i bërë
7 kundërpjetet atij dëshmitari sepse është e njëjta ekonomi
8 gjyqësore.

9 Në këtë rast, për shembull, deklaratat e dëshmitarëve të
10 ZPS-së janë, faktikisht, intervista në disa raste të përbëra
11 prej disa pjesëve. Por atë që e kam thënë në atë konferencë të
12 ecurisë është e zbatueshme vetëm në rastet kur Trupi Gjykses
13 merr një qëndrim të tillë për shfrytëzimin e kohës maksimale
14 për çdo ekip të Mbrojtjes. Në qoftë se ka një rregull që thotë
15 që koha standarde që i jepet çdo ekipi të Mbrojtjes është, të
16 themi, 15 minuta, 30 minuta, atëherë dhe nëse kjo na thuhet
17 paraprakisht dhe na jepen arsyet sepse, për shembull, ky
18 dëshmitar, pyetjet për këtë dëshmitar, mund të zgjatin më
19 shumë. Kjo është një praktikë që përdoret në shumë gjykata
20 ndërkombëtare dhe që zgjidh shqetësimet që mund t'i kenë në
21 lidhje me paraqitjen e provave dhe kohën e duhur për këtë.

22 Por duhet një farë disipline. Dhe vendosja e një
23 disipline të tillë, unë, personalisht, nuk e kundërshtoj.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju faleminderit, z.
25 Emmerson. E kuptuam atë që deshët të thoni.

1 Pyetja ime është: Në atë parashtrim i referoheshit
2 jurisprudencës së TPNJ-së?

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të kisha thënë më shumë
4 praktikë gjyqësore. Sepse ata Trupa Gjykses, në ato gjykata, e
5 kanë të drejtën diskrecionale për t'i marrë parasysh nevojat
6 për një kohë standarde me përjashtime, gjithsesi, që mund t'i
7 jepen një pale për të bërë pyetjet.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë a është e mundur që
9 në një fazë të mëvonshme t'i jepni Trupit Gjykses referenca në
10 lidhje me këtë?

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, do të japim shembuj se ku
12 është përdorur kjo praktikë. Për shembull, e di që është
13 përdorur për herë të parë në një konferencë për menaxhimin apo
14 administrimin e procesit gjyqësor si kjo. Por, pavarësisht, ne
15 do t'jua japim të gjitha referencat.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. Emmerson, ju gjithashtu bëtë disa komente interesante
18 në lidhje me dëshmitarët e rregullit 153 dhe po citoj:

19 "Trupi Gjykses duhet t'u japë peshë më të vogël dëshmive
20 të dëshmitarëve që nuk mund të merren në pyetje gojarisht. Ky
21 është ligji. Kjo është praktika. Kjo nuk do të thotë se ajo
22 dëshmia e tyre është më pak e vlefshme, mirëpo është
23 jashtëzakonisht e vështirë që të merret e gjitha parasysh".

24 Dhe kjo është nga konferenca statutore e datës 8 shtator
25 2022.

1 Për çfarë e keni fjalën konkretisht këtu, z. Emmerson?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Rregullat 153 dhe 155 duhet të
3 shikohen së bashku sepse këtu bëhet fjalë për paraqitjen e --
4 për mosparaqitjen e dëshmitarëve, domethënë kur dëshmitarët
5 nuk vijnë për të dhënë dëshmi gojore.

6 Rregulli 153 bën fjalë për dëshmi në kuptimin që nuk mund
7 -- që nuk ka të bëjë me veprimet apo sjelljen e një të
8 akuzuari, prandaj pavarësisht se çfarë është rezultati i një
9 gjykimi. Është fjala për një material të mëparshëm.

10 Pragu i nxjerrjes ë materialeve në raste të tilla
11 shoqëron apo zëvendëson atë që mund të përdoret në qoftë se
12 dëshmitari do të jepte dëshmi gojore dhe gjithashtu zvogëlon
13 besueshmërinë e atij dëshmitari.

14 Pra, nuk është puna vetëm në qoftë se vetë prova apo
15 dëshmia është relevante, por është fjala edhe e besueshmërisë
16 së dëshmitarit.

17 Unë, sigurisht që do të bëj parashtrim me shkrim, por
18 është një procedurë universale që përdoret nëpër
19 jurisprudencat e shteteve. Do t'ju japim me shkrim brenda 24
20 orëve të gjitha referencat në lidhje me dispozitat dhe
21 praktikat e tribunalëve ndërkombëtarë në lidhje me këtë
22 aspekt.

23 Në qoftë se, për shembull, pranohet një dëshmitar i
24 rregullës 155, mbi dëshminë e të cilit mund të bazohet një
25 vendim fajësie, atëherë është e qartë se kjo duhet të

1 shoqërohet me mundësinë për ta marrë plotësisht në pyetje atë
2 dëshmitar.

3 Unë jam i sigurt që do të gjejmë jurisprudencën përkatëse
4 si në TPNJ, ashtu edhe në Gjykatën Penale Ndërkombëtare në
5 lidhje me të gjitha ato që i kam thënë në konferencën për
6 ecurinë e çështjes që e cituat.

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.
9 Do ta çmoj në qoftë se i dërgoni këto referenca.

10 Dhe pyetja ime e fundit në lidhje me parashtrimet tuaja
11 në atë konferencë, përsëri mbështetem në transkriptit e datës
12 8 shtator 2022, rreshtat 15 deri në 23 të faqes 1520, deri në
13 faqen 1521, rreshtat 1 deri në 4:

14 "Detyrimet e nxjerrjes së materialeve të Prokurorisë në
15 ato raste janë më të larta sesa detyrimet e nxjerrjes së
16 materialeve në rastin e dëshmitarëve që ftohen për të dhënë
17 dëshmi sepse Prokuroria duhet, në atë rast, t'ia nxjerrë
18 Trupit Gjykses dhe palëve të gjitha materialet që mund të
19 ndikojnë në kredibilitetin e dëshmitarit dëshminë e të cilit
20 po e paraqet si provë.

21 Ndryshe, në qoftë se nuk bëhet kjo, Prokuroria duhet ta
22 bindë Trupin Gjykses se Trupi Gjykses dhe Mbrojtja kanë çdo
23 gjë të mundshme në dispozicion për të vlerësuar peshën që
24 duhet t'i jepet deklaratës apo transkriptit të atij
25 dëshmitari"

1 Z. Emmerson, a keni mbështetje nga jurisprudenca
2 ndërkombëtare në lidhje me këto që keni cituar që ua citova?

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Detyrimi i nxjerrjes nuk është
4 vetëm për materialet që ka në posedim Prokuroria, por edhe
5 shkon edhe përfshinë edhe materialet që në cilat mund të ketë
6 qasje Prokuroria. Këto detyrime janë të vazhdueshme të
7 Prokurorisë.

8 Dhe kjo është e zbatueshme edhe nga këndvështrimi
9 konvencional. Pra, i njëjti detyrim shkon edhe për dëshmitarët
10 dhe për pjesët përkatëse të dëshmive të tyre. Pra, Prokuroria
11 duhet të bëjë çmos në mënyrë që të vlerësojë në qoftë se
12 dëshmitari që ka është i besueshëm përpara se t'i ftojë këtu
13 për të dhënë dëshmi. Dhe kjo është pjesë e etikës profesionale
14 të Prokurorisë.

15 Mua nuk më pengon që ta trajtojë hollësisht
16 jurisprudencën sipas nenit 6 të Strasburgut dhe jurisprudencës
17 së Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Njeriut,
18 sipas të cilave detyrimi i nxjerrjes së materialeve tejkalon
19 thjesht rishikimin nga ana e Prokurorisë e materialeve që ka.
20 Ata, për shembull, Prokuroria, duhet të shikojë në qoftë se
21 një dëshmitar ka dëshmi kriminaliteti ose jo. Pra, çdo aspekt
22 që mund të ndikojë në kredibilitetin dhe mbështetshmërinë e
23 dëshmisë së atij dëshmitari. Dhe kjo është një nga aspektet më
24 materiale të kësaj çështjeje.

25 Në qoftë se një dëshmitar paraqitet në bazë të dëshmisë,

1 dorëzimit të dëshmisë si provë, atëherë përpara se t'i
2 paraqitet Trupit Gjykes një dëshmi që, në fakt, mund të mos
3 jetë aq e vlefshme apo që vjen nga një burim i cili pas një
4 analizimi më të hollësishëm tregohet se është i pavlefshëm.

5 Atëherë, Trupi Gjykes mund të ushtrojë të drejtën e vet
6 diskrecionale për pranimin e provave shkresore pa nevojën për
7 ta marrë në pyetje një dëshmitar.

8 Pra, nëse më lejoni të elaboroj. Unë i përdora këto
9 dëshmitë e kriminalitetit vetëm si shembuj. Shumë dëshmitarë
10 që Prokuroria synon t'i thërrasë në këtë çështje janë të
11 përfshirë apo të implikuar në një mënyrë drejtpërdrejtë ose
12 tërthor me shërbimet e inteligjencës të Serbisë.

13 Dhe hapi i parë që është debatuar, që ka qenë objekt i
14 debatimit ligjor, është deri në çfarë mase duhet Prokuroria
15 t'i tregojë Mbrojtjes se këto dëshmi të tilla vijnë nga
16 Serbia. Dhe Trupi Gjykes në një vendim të kohëve të fundit
17 konfirmoi vendimin e gjykatësit të Procedurës Paraprake.

18 Pse është kjo e rëndësishme? Përgjigja është: Është hapi
19 i parë në shqyrtimin e asaj sesi këta dëshmitarë janë të
20 përfshirë në aktivitete që mund të manipulohen nga shërbimet e
21 inteligjencës në bazë të provave dhe përfundimeve para TPNJ-së
22 në rastin Limaj dhe Haradinaj, sepse atje në mënyrë rutinore
23 janë manipuluar provat.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,
25 po e zgjasim shumë pa nevojë.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Thjesht po
2 përpiqem t'i përgjigjem pyetjes që më bëri kolegu juaj.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ardhur
4 koha për pushim. Tani do të bëjmë pushimin. Do të kthehemi në
5 orën 11.30 për seancën e dytë.

6 --- Pauza fillon në orën 11.00

7 --- Seanca rifillon ne orën 11.29

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju
9 lutem.

10 Mendoj se Gjykatësi Mettraux ka ende disa pyetje.
11 Vazhdoni, ju lutem.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja e
13 parë është ZPS-në. Ndoshta ju, z. Halling, na përgjigjeni. Ka
14 të bëjë me pretendimet në aktakuzë, për periudhën që ju thoni
15 që kishte konflikt të armatosur në të gjitha vendet dhe
16 periudhat që përmenden në aktakuzën tuaj.

17 Tani, unë dua të garantohemi që i kemi kuptuar siç duhet.
18 Ju thoni që konflikti i armatosur që pretendoni ju, është i
19 natyrës jo ndërkombëtare, a është kështu?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Kësaj pyetjeje do t'i përgjigjet
21 z. Tieger në fakt.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mikrofonin,
23 ju lutem.

24 Z. TIEGER [Përkthim]: Mirëmëngjesi.

25 Po, po. Përgjigja është po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

2 E dyta, aktakuza nuk duket se ka ndonjë specifikim të
3 periudhës ku pretendoni ju se filloi konflikti i armatosur dhe
4 Mbrojtja e Selimit e interpretoi këtë në një mënyrë të atillë,
5 për ta kuptuar -- pra ju thoni se kishte konflikt të armatosur
6 jondërkombëtar që ka filluar në mars të vitit 1998. Tani çfarë
7 duam ne të kuptojmë prej ju është nëse Mbrojtja e Selimit e ka
8 kuptuar siç duhet apo jo.

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Përgjigja në fakt, po, mbetet po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i jap shansin edhe
11 Mbrojtjes, sigurisht, të flasë në lidhje me këtë.

12 Pyetja e fundit për ju është për fundin e konfliktit,
13 përfundimin e konfliktit. Me sa duket, të paktën tre nga
14 ekipet e Mbrojtjes nuk është se e kanë të paqartë ekzistencën
15 e këtij konflikti në këtë fazë, por me sa duket nuk pajtohen
16 me kohëzgjatjen e këtij konflikti. Janë të mendimit që
17 konflikti që pretendoni ju, duhet të ketë mbaruar në qershor
18 të vitit 1999. Ndërsa sipas jush duket sikur ka zgjatur deri
19 në shtator të vitit 1999. Në fakt duket sikur pretendoni se ka
20 pasur konflikt të armatosur përfshirë shtatorin të vitit 1999
21 apo ju thoni që konflikti ka mbaruar që më herët, ama pati
22 pasoja deri në muajin shtator të vitit 1999. Me fjalët të
23 tjera, a doni të thoni ju që konflikti vijoi deri në shtator
24 të vitit 1999 apo keni dashur të thoni diçka ndryshe që nuk
25 është kuptuar.

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit që na dhatë mundësinë
2 ta sqarojmë këtë gjë, i nderuar Gjykatës.

3 Që ta kuptojmë, sigurisht, ne biem dakord që ka pasur
4 pasoja dhe pas përfundimit të konfliktit të armatosur, sikurse
5 ndodh zakonisht me konfliktet e armatosura.

6 Megjithatë, ne jemi të mendimit që konflikti nuk
7 përfundoi deri në muajin shtator të vitit 1999.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E qartë. Faleminderit, z.
9 Tieger. Do flas përsëri me ju dhe tani do t'i jap fjalën
10 Mbrojtjes së z. Selimi dhe ekipeve të tjera. Do ua jap fjalën
11 edhe ju, z. Kehoe, po t'ja japim njëherë fjalën një ekipi
12 tjetër, mbase si fillim Mbrojtjes së z. Selimi, z. Tully, ju
13 shoh që jeni çuar në këmbë. Doni të ngrini diçka lidhur me
14 parashtrimin e ZPS-së mbi këtë pikë? Po edhe diçka disi më
15 ndryshe por që është pjesë e të njëjtit aspekt. Me sa duket,
16 në dosjen tuaj, lidhur me ekzistencën e konfliktit në mars të
17 vitit 1998, a është kjo pikëpamja juaj që nuk ka pasur
18 konflikt të armatosur në atë periudhë të caktuar kohore?

19 Ne prej jush duam konkretisht të dimë çfarë jurisprudence
20 apo çfarë baze ligjore ishte në fuqi asokohe, nëse kishte
21 konflikte, nëse kishte sulme. Atëherë, si do ta verifikoni ju
22 ligjshmërinë e këtij veprimi. A e kuptoni pyetjen time?

23 Z. TIEGER: [Përkthim] Po, po. E kuptoj, i nderuar
24 Gjykatës.

25 Por në fakt, për fillimin e konfliktit të armatosur në

1 fakt është interpretimi jonë: konflikti nuk ka filluar në
2 mars. Ky është qëndrimi ynë sot lidhur me këtë.

3 Për ne ligji nuk është se është diçka që duam ta
4 diskutojmë këtu mes palëve, sepse është përcaktuar kjo në
5 vendimin e konfirmimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake,
6 edhe përmendet në nenin 14(2) të Ligjit që reflekton
7 jurisprudencën e ICC-së. Dhe dy parimet kryesore janë
8 organizimi i palëve, që në këtë rast është UÇK-ja konkretisht
9 në rastin tonë, dhe së dyti, niveli i intensitetit që synohet
10 të jetë ekzistues në një konflikt para se të përcaktohet që
11 është konflikt i armatosur ndërkombëtar. Dhe për pikën e dytë,
12 neni 14(2) shprehimisht specifikon jurisprudencat që janë të
13 mirëngritura, që do të thotë që konfliktet e brendshme apo
14 sulmet e brendshme dhe veprimet e natyrës së ngjashme, nuk
15 kategorizohen si konflikte të armatosura ndërkombëtare.

16 Ta përmbledhim. Në thelb, i nderuar Gjykatës, pra
17 mendojmë që, në qoftë se ka filluar në mars, ka pasur
18 intensitetin më të ulët të mundshëm. Pra, nuk e ka kaluar
19 pragun për ta quajtur si të tillë.

20 Pra ne nuk dhamë ndonjë datë specifike, sikurse edhe nuk
21 dha as Prokuroria datë specifike për përfundimin e konfliktit,
22 se nuk gjykojmë se jemi ne personat e duhur për ta thënë këtë.
23 Por, nga gjykimi Limaj, është shumë e qartë që çdo vlerësim
24 për ekzistencën e një konflikti jondërkombëtar të armatosur,
25 vlerësohet rast pas rasti, në bazë të fakteve ekzistuese.

1 Megjithatë, i nderuar Gjykatës, mund të bazoheni në
2 shqiptimet e aktgjykimeve nga jurisprudencat ekzistuese mbi
3 këto çështje. Ne kemi parë edhe çështjet vendase, për
4 jurisprudencën e TNPJ-së, disa thonë që ka filluar në mes të
5 vitit 1998, disa thonë në prill, disa thonë në maj, disa thonë
6 qershor. Pra ne sigurisht u bazuam në çështjet vendase që janë
7 diskutuar në këtë aspekt, edhe sigurisht ne u bazuam në
8 aktgjykimin e 27 majit të vitit 2014, që është shqiptuar nga
9 Gjykata e Apelit në Kosovë. Numri i çështjes gjyqësorë është
10 PAKR503/13, në faqet 18 dhe 19, ku konstatoj se konflikti i
11 vazhdueshëm mes UÇK-së dhe TPJ-së zgjati nga shkurti i vitit
12 1998 deri në qershor të 1998, që e bën edhe më të ngatërruar
13 pak çështjen.

14 Pra, sa i takon datës së konfliktit, thuhet që është
15 afërmendsh, kuptohet, dhe nuk kërkohet një datë e saktë.
16 Sigurisht ne mund të shohim edhe të dhënat e Departamentit të
17 Shtetit të SHBA-së, që është përditësuar për herë të fundit me
18 sa di unë, vetëm rishtazi, ku i referohet vitit 1999 si viti
19 kur ka ndodhur kriza në Kosovë.

20 Gjithashtu mund të fokusohemi, të shohim një çështje të
21 Gjykatës Themelore të Prishtinës, që po ashtu mbështetur në
22 jurisprudencat Haradinaj dhe Limaj. Aty thuhet që konflikti ka
23 filluar në fund të prillit - fillim maji përkatësisht.

24 Dhe po ashtu, mund të shohim edhe një aktgjykim në
25 Djordjevic, ku thuhet maj i vitit 1998.

1 Ne nuk po themi që ju domosdoshmërisht të bazoheni në këtë
2 jurisprudencë, se ju i keni të qarta, por ne mendimin tonë,
3 duke marrë parasysh të gjitha këto burime ligjore, duhet
4 argumentuar dhe diskutuar me Prokurorinë nëse me të vërtetë
5 filloi në vitin 1998, në mars të vitit 1998 ky konflikt, apo e
6 kanë gabim të gjitha këto burime të tjera ligjore që përmenda
7 më herët.

8 Duhet të shikojmë edhe të drejtën e të drejtave të
9 njeriut asokohe, si edhe ligjet në fuqi për Republikën
10 Federale të ish-Jugosllavisë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për
12 përgjigjen e hollësishme. Sigurisht, z. Tully, nuk presim që
13 të në ja jepni ju datën lidhur me këtë çështje. Ajo që ne duam
14 të dimë, më shumë, më konkretisht, është nëse duhet të
15 vlerësojmë ligjshmërinë e disa veprimeve që janë kryer në
16 shkurt apo në mars të vitit 1998.

17 Pyetja që kam unë në mendje është: cili burim ligjor
18 duhet të merret parasysh për këtë vlerësim. Hipotekisht mund
19 të them, e zëmë se është bërë një sulm për stacionin e
20 policisë, dhe ju thoni se s'kishte konflikt të armatosur dhe
21 rregullorja nuk është e zbatueshme për këtë. Por duhet të
22 vlerësohej përkundrejt ligjeve vendase që ishin në fuqi
23 asokohe sa i takon natyrës penale të këtij sulmi.

24 Nuk dua të më përgjigjeni tani domosdoshmërisht, dhe
25 sigurisht merrni kohën që ju duhet. Thjesht ne duam të jemi të

1 qartë të kuptojmë më konkretisht se si është qëndrimi juaj
2 lidhur me këtë pikë.

3 Z. Tully, ju keni një sëmundje si puna ime, flisni shumë
4 shpejt.

5 Z. TULLY: [Përkthim] Në fakt kur je në këmbë të duket
6 sikur flet ngadalë. Ju kërkoj ndjesë për këtë.

7 Sa i takon bazës ligjore, do të duhet ta shqyrtoj pak më
8 tej. Nuk është diçka që e kisha menduar paraprakisht, të
9 paktën për nga mënyra se si u formulua pyetja. As nuk i
10 kushtova rëndësi nga urdhri për zhvillimin gjyqësor.

11 Megjithatë, nëse duhet përcaktuar qartë për këto akuza, pikë
12 se pari duam të dimë çfarë ligjesh kanë ata parasysh, që i
13 konsiderojnë krime dhe pastaj të kuptojmë nëse Gjykata ka
14 juridiksion për këto krime.

15 Për momentin, nëse më kërkon -- ju kërkoj ndjesë, do ta
16 le me kaq.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Kehoe, me sa kuptoj do
18 të flisni bashkë me z. MISETIC lidhur me këtë pikë.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, do të kemi kënaqësinë të dëgjomë
20 z. MISETIC lidhur me këtë pikë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

22 Pikë së pari, pajtohem me atë që tha z. Tully, por dua të
23 shtoj diçka.

24 Pikë së pari, Prokuroria ka barrën e provës për
25 ekzistencën e konfliktit të armatosur përtej dyshimit të

1 arsyeshëm. Kjo është përcaktuar në fakt edhe nga Trupi Gjykses
2 në çështjen Rutaganda, paragrafët 557 et seq, ku thotë se
3 Prokuroria të vërtetojë që nuk ka pasur konflikt të armatosur
4 pas qershorit të vitit 1999. Sigurisht që do të merrni
5 parasysh të gjitha jurisprudencat e tjera, sa i takon
6 përmbushjes së këtij kriteri. Ekzistojnë në fakt një sërë
7 jurisprudencash. Ju keni parë dosjen tonë gjyqësore. Kemi
8 cituar pikë së pari TPNJ-në në fakt dhe sikurse tha edhe z.
9 Tully, ka pasur disa aktgjykime për këtë, që njëri syresh
10 është i z. Haradinajt, ku thuhet në poshtëshënimin 2039 që
11 konflikti i armatosur në Kosovë përfundoi në qershor të vitit
12 1999.

13 Po ashtu, Prokurorët e TPNJ-së thanë se nuk mund të
14 hetonin krime që kanë ndodhur në Kosovë pas qershorit të vitit
15 1999, pikërisht sepse nuk kishte konflikt të armatosur.

16 Pra, jemi në një situatë ku prokurori i TPNJ-së i bëri
17 petition Këshillit të Sigurisë që të ndryshonte statusin e
18 TPNJ-së dhe t'i jepte juridiksion të hetonte edhe krimet që
19 kanë ndodhur në Kosovë pas qershorit të vitit 1999.

20 Nëse është kështu, atëherë Prokuroria duhet të ketë
21 çështjen të atillë që të thotë: Ai prokurori i TPNJ-së e ka
22 bërë gabim punën, ka qenë gabim. Në fakt, asnjë prokuror i
23 arsyeshëm nuk duhet të kishte arritur në përfundimin sipas
24 tyre, siç arriti prokurori i TPNJ-së. Domethënë që nuk ka
25 pasur konflikt të armatosur në Kosovë pas vitit 1999.

1 Tani pikëpyetja jonë është: cili është qëndrimi i
2 Prokurorisë përkundrejt qëndrimit të TPNJ-së. A kanë këta
3 prova të reja që janë me vlerë, me rëndësi, dhe që hedh dritë
4 në fakte të reja dhe ne duhet të fokusohemi në prova të reja
5 në këtë gjykim, apo thjesht thonë që prokurori i TPNJ-së ka
6 bërë një vlerësim të gabuar sa i takon zbatueshmërisë apo
7 ekzistencës së konfliktit të armatosur asokohe. Nëse është kjo
8 e fundit, atëherë prokurori i TPNJ-së në vetvete është dyshim
9 i arsyeshëm që nuk ka pasur konflikt të armatosur pas
10 qershorit të vitit 1999.

11 Sa i takon fillimit të konfliktit, nuk do përsëris çfarë
12 tha z. Tully, por thjesht dua të shtoj se në gjykimin e
13 Haradinajt, një nga akuzat kundër z. Haradinaj u hodh poshtë
14 pikërisht sepse incidenti u konstatua se kishte ndodhur para
15 22 prillit të vitit 1998 dhe prandaj Gjykata nuk kishte
16 juridiksion. Tani ZPS-ja po ndryshon kohën, po e thotë se
17 është mars, kur në fakt, po e thoni ju, po e konstatoni, që
18 në çështjen Haradinaj TPNJ-ja ka vepruar gabim, sepse e hodhi
19 poshtë akuzën, sepse sipas tyre nuk kishte konflikt të
20 armatosur në për atë pikë.

21 Pra burimi ligjor i TPNJ-së është i rëndësishëm që ju të
22 vlerësoni standardin e dyshimit të arsyeshëm, nëse është edhe
23 rasti ynë, nëse përmbushet edhe në rastin tonë.

24 Nëse shohim raportin e Marty-t, ku thuhet në paragrafin
25 tjetër, dhe po citoj:

1 "Tribunali ndërkombëtar, që do të thotë TPNJ-ja, kishte
2 përgjegjësinë të gjykonte vetëm ato vepra penale që kanë
3 ndodhur deri në qershor të vitit 1999".

4 Tani, kjo na nxjerr një problematikë tjetër procedurale,
5 që donim ta ngrinim, që ju nuk e përmendët më herët, që është
6 vlerësimi më i hershëm i Trupit Gjykses për ekzistencën ose
7 joekzistencën e konfliktit të armatosur, edhe i një sulmi më
8 të gjerë sistematik, a ka rezultuar -- nëse do të thoni ju se
9 nuk ka pasur konflikt të armatosur më herët dhe me sa kuptojmë
10 ne nga dosja e Prokurorisë, ata po mbështeten në prova
11 shkresore për të mbështetur ekzistencën e konfliktit të
12 armatosur, dhe me sa besoj unë, katër dëshmitë që synojnë të
13 thërrasin ata, janë për konflikt pas qershorit të vitit 1999.

14 Nëse ju doni të dilni në përfundimin se nuk e përmbushin
15 standardin për ekzistencën e konfliktit të armatosur, atëherë
16 janë një sërë dëshmitarësh dhe dokumentesh që nuk duhet të
17 merren fare parasysh ose nuk duhet të paraqiten këtu dhe kjo
18 do të na kursente goxha kohë.

19 Në vend që t'i dëgjojmë të gjithë këta dëshmitarë dhe
20 pastaj në fund të gjyqimit ju të thoni që nuk jeni dakord ju
21 me përfundimet e TPNJ-së për përfundimin e konfliktit të
22 armatosur.

23 Tani cili ligj zbatohet, atëherë, për marsin e vitit
24 1999? Duam të diskutojmë pak më shumë lidhur me këtë pikë.
25 Pajtohem me z. Tully lidhur me këtë.

1 Nuk është kaq e mirëfilltë kjo pikë. Ligjet vendase janë
2 të zbatueshëm. Cili ligj duhet ta shqyrtoj më tej? Ky është
3 një institucion i Kosovës, kjo është e qartë, kështu që duhet
4 të përcaktojmë dhe duhet të shohim çfarë pozicionesh ka pasur
5 Kosova sa i takon ligjeve që kanë qenë në fuqi në vitin 1999,
6 para se t'i revokohej autonomia apo nëse ligji i vitit 1999
7 dhe ligji që kishte ndryshuar Serbia. Pra, ne duhet të marrim
8 disa udhëzime, të bëjmë disa hulumtime, për të parë se çfarë
9 kanë konkluduar institucionet në Kosovë në lidhje me këtë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E vlerësoj këtë, z.
11 MISETIC. Para se të uleni, a më lejoni ju lutem t'ju pyes dhe
12 lidhur me pikën që ngrita me z. Tieger, për mundësinë -- për
13 një mundësi, domethënë. Supozojmë që Trupi Gjykses bie dakord
14 me pikën tuaj që konflikti ka përfunduar në vitin 1999, dhe
15 pati pasoja edhe pas qershorit, sa i takon pikëpamjes të së
16 drejtës ndërkombëtare deri në shtator. Ju e keni menduar këtë,
17 jeni përgatitur të na bëni të qartë qëndrimin tuaj apo doni të
18 merrni udhëzime të mëtejshme për këtë, të cilën sigurisht do
19 ua japim këtë kohë.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Sigurisht krimet kundër njerëzimit
21 vlejné nëse thua që ka pasur vërtetë sulme të gjera dhe
22 sistematike që zgjatën deri në shtator. Atëherë sigurisht që
23 ka të bëjë kjo me ekzistencën e një konflikti të armatosur. Po
24 kjo është një pikë tjetër që ne do ta trajtojmë më vonë sot
25 gjatë seancës.

1 Megjithatë, nuk bie dakord me parashtrimin e z. Tieger,
2 se konflikti i armatosur i përcaktuar në të drejtën
3 ndërkombëtare humanitare vazhdoi përtej përfundimit të
4 konfliktit të armatosur. Pra nëse ka një datë përfundimtare
5 apo një periudhë përfundimtare që e konkludoi edhe TPNJ-ja
6 është, në momenti që konflikti i armatosur, nuk ka asnjë bazë
7 për të hetuar më tej kryerjen e krimeve të luftës.

8 Kështu që ne e ndjekim praktikën -- jemi dakord me
9 praktikën e TPNJ-së. Ne mendojmë se kjo mjafton në vetvete që
10 edhe ju të dilni në përfundimin nëse ka pasur dyshim të
11 arsyeshëm në qoftë se ky konflikt i armatosur vijoi për pas
12 qershorit të vitit 1999.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. MISETIC.
14 z. Emerson?

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pikë së pari, nuk i diskutojmë
16 farë këto që tha Mbrojtja e z. Veseli. Kemi të njëjtin
17 qëndrim. Është e nevojshme që Trupi Gjykses të përcaktojë
18 përfundimin e konfliktit të armatosur sepse kjo është edhe
19 periudha kur ishte në fuqi ligji i luftës.

20 Sa i takon ngjarjeve para apo pas kësaj periudhe, ka
21 ligje vendase në fuqi që kanë qenë në fuqi në ato periudha.
22 Siç tha z. MISETIC, kjo do të thotë se në qoftë se duhet të
23 konstatojmë se ka pasur sulme të gjera dhe sistematike ndaj
24 popullatës civile dhe këto krime bënë pjesë në këtë, atëherë
25 teorikisht këto krime, këto sjellje, potencialisht do të ishin

1 prova ose pjesë e kuadrit të krimeve kundër njerëzimit. Por
2 nuk është ngritur asnjë akuzë për këtë, në bazë të
3 legjislacionit penal vendas dhe rrjedhimisht nuk bën pjesë në
4 juridiksionin e kësaj Gjykate.

5 Sa i takon përfundimit, janë paraqitur një numër datash
6 në këtë drejtim dhe do jap edhe referencat në rend kronologjik
7 të aktgjykimeve. Në gjykimin Limaj, që doli më 30 nëntor të
8 vitit 2005, paragrafi 171, Trupi Gjykses ishte i bindur se në
9 fund të majit kishte konflikt të armatosur. Pra, në fund të
10 majit ishte data që kanë dhënë në çështjen Limaj.

11 Në aktgjykimin e Haradinajt, që doli më 3 prill të vitit
12 2008, paragrafi 100 -- duhet t'i lexojmë pak me kujdes këto në
13 fakt, kishte një akuzë në aktakuzë ku përmendej data 18 prill,
14 një akuzë në aktakuzë që mbante datën disi më vonë që ishte
15 besoj 23 prill. Kishte shumë prova, sigurisht, që lidheshin me
16 situatën pas Jasharit, pra sulmit që ndodhi në banesën e
17 Jasahrit dhe sulmet nga forcat serbe më datën 25 mars. Kishte
18 raste sporadike ku rritej intensiteti në pjesën perëndimore të
19 vendit. Në këtë kontekst, në paragrafin 100 thuhet se kishte
20 konflikt të armatosur për pikën e dytë, pra për akuzën e dytë
21 që është data 23 prill, por më 18 në fakt jo. Pra, ngjarjet u
22 intensifikuan në zonën e Dukagjinit në Kosovë dhe Gjykata tha
23 këtu arriti kulmi dhe mbasi Dukagjini -- se po fokusohemi te
24 Dukagjini -- nuk kundërshtojmë propozimin që dha z. Selimi dhe
25 z. Thaçi që Gjykata të tjera dhanë një datë të mëvonshme,

1 thonë edhe vera, por ne themi që nuk mund të ketë ndodhur para
2 22 prillit dhe mbase këtu duhet të flasim me parimin e
3 ligjshmërisë, zbatueshmërisë sipas statutit të kësaj Gjykate,
4 neni 7, të kemi një farë konsistence juridike dhe sigurie
5 juridike.

6 Por kjo nuk është një datë ku duhet të mbështetet ky Trup
7 Gjykues dhe kjo Gjykatë. Në këtë proces atëherë i bie që ne të
8 dalim me një përfundim ndryshe nga Gjykatat e tjera.

9 Në Milutinovic, që është 26 shkurt 2009, paragrafi 841
10 përfundimi është se konflikti i armatosur filloi jo më vonë se
11 sa vera e vitit 1998.

12 Djordjevic, gjykimi 23 shkurt i vitit 2011, thuhet se
13 filloi në fund të majit të vitit 1998, paragrafi 1579, që në
14 fakt kjo është në përputhje me edhe me konstatimin lidhur në
15 çështjen e Limaj.

16 Në rigjykimin e Haradinajt pati një pajtim faktik mes
17 palëve, që konflikti i armatosur kishte ekzistuar për të
18 gjithë periudhën në aktakuzën e rigjykimit. Pra, nuk ishte e
19 nevojshme që Trupi Gjykues që bëri rigjykimin të hynte në
20 analizë të mëtejshme sepse kishte tjetër kuadër, pra ishte e
21 qartë që kishte konflikt të armatosur, kuptohet.

22 Sa i takon fillimit, provat na tregojnë se ka qenë fundi
23 i majit - fillimi i qershorit, pak a shumë në ato periudha
24 kohore dhe mendojmë se burimi kryesor është Haradinaj, ku jep
25 një datë specifike që flasim mes 18 dhe 23 prillit.

1 Megjithatë, kjo duhet analizuar nga prizmi i një konflikti të
2 armatosur brenda rajonit të Kosovës, konkretisht në kufi me
3 Shqipërinë.

4 Ka baza ligjore që thonë qershori, por ne themi që duhet
5 të jenë këto të gjitha në përputhje me parimin e sigurisë
6 ligjore, në bazë të nenit 7. Ka një sërë -- sigurisht, janë
7 përmendur disa situata në aktakuzë --

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vazhdoni, Z. Emmerson,
9 ndjesë.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] -- që në të vërtetë janë jasht
11 kuadrit të akuzave për krime lufte dhe për arsye të tjera, ne
12 parashtrojmë se nuk përbëjnë krime kundër njerëzimit.

13 Shkurtimisht ne duam të themi se më 3 qershor Presidenti
14 Millosheviç, pranoi planin ndërkombëtar të paqes dhe ra dakord
15 t'i jepte fund luftimeve dhe u miratua në Parlamentin serb kjo
16 gjë. Pra, zyrtarisht, më 3 qershor përfunduan luftimet dhe më
17 10 qershor Këshilli i Atlantikut Verior miratoi marrëveshjen e
18 Kumanovës dhe ndërpreu të gjitha operacionet nga ajri që
19 Këshilli i Sigurisë së OKB-së po ashtu më 10 qershor miratoi
20 Rezolutën 1244, ku alokoi autoritete ushtarake dhe civile në
21 Kosovë.

22 Dhe po ashtu më 12 qershor forcat NATO hynë në Kosovë.

23 Më 20 qershor të gjitha forcat serbe u tërhoqën nga
24 territori dhe nuk pati më sulme që po e bëjnë apo nënkuptojnë
25 që kishte ende konflikt të armatosur. Tani, sigurisht, sa i

1 takojnë pasojave të mëvonshme, cili është pozicioni ynë. Është
2 që dallimi është mes krimeve të luftës dhe krimeve kundër
3 njerëzimit, sa i takon kësaj aktakuzë. Akuzat për krimet e
4 luftës kërkojnë -- sigurisht përfundojnë kur përfundon edhe
5 konflikti. Krimet kundër njerëzimit - kjo është vetmja pasojë
6 që vijon dhe sigurisht vetëm në rast se ka një sulm të gjerë,
7 sistematik kundër popullatës civile, për arsye të cilat do t'i
8 diskutojmë më vonë. Sigurisht ne mendojmë që kjo është e
9 diskutueshme.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Qëndroni në këmbë, z.
11 Emmerson se besoj se Gjykatësi Barthe ka një pyetje.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

13 Në fakt desha një sqarim me z. Mishetiç, por ndoshta mund
14 t'ju kthehem edhe juve, z. Emmerson, pasi të kemi siguruar
15 këto sqarime.

16 Por, ka të bëjë me të njëjtën çështje që ngritët edhe ju,
17 z. Emmerson dhe ju z. Mishetiç, në parashtrimet tuaja.

18 Pyetja ime, dhe po i kthehem asaj që tha z. Mettraux, pra
19 efektit normativ apo efektit të vazhdimësisë të ligjit
20 ndërkombëtar humanitar. Pyetja është që: në qoftë se një
21 person mbahet i paraburgosur në mënyrë të ligjshme apo të
22 paligjshme para përfundimit të një konflikti të armatosur dhe
23 që vazhdon të mbahet i parandaluar edhe pas përfundimit të
24 konfliktit të armatosur, a është qëndrimi juaj që ky person
25 nuk gëzon mbrojtjen në bazë të së drejtës humanitare

1 ndërkombëtare?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne do të thoshim që sigurisht që
3 do të gëzonte mbrojtje pas përfundimit të luftimeve dhe në
4 pyetje specifike që ngritët ju lidhur me përfundimin apo datën
5 e saktë të përfundimit të një konflikti të armatosur, më duhet
6 të bëj kërkime të mëtejshme. Nuk do ta jap dot përgjigjen
7 aktualisht. Nuk di se për sa persona bëhet fjalë në këtë
8 çështje penale por besoj që do të jap një përgjigje më të
9 saktë përpara përfundimit të ditës së sotme.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Mishetiç,
11 unë po flisja në mënyrë hipotetike.

12 Ndoshta z. Emmerson do të japë ndonjë koment.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] E kemi trajtuar një çështje të
14 lidhur me këtë në dosjen tonë paraprake dhe pas kësaj seance
15 mund të tregoj saktësisht cilën pjesë. Pra për sa i përket
16 veprës penale të paraburgimit.

17 Qëndrimi ynë është, dhe ky është edhe qëndrimi i Grupit
18 të Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara, është që ndalimi
19 arbitrar nuk është një veprë penale brenda së drejtës
20 humanitare ndërkombëtare por në rastin e një konflikti jo
21 ndërkombëtar. Dhe në qoftë se kemi të drejtë për këtë çështje,
22 atëherë kjo nuk kishte qenë një veprë penale edhe në kohën e
23 pas përfundimit të luftimeve.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ka ndonjë koment tjetër

1 Mbrojtja e Krasniqit?

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, ne i
3 mbështesim parashtrimet që janë bërë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
5 z. Ellis.

6 Z. Halling, a keni ndonjë gjë për të thënë si përgjigje,
7 ju apo z. Tieger? Në qoftë se dëshironi diçka pak më vonë, e
8 keni të drejtën për ta bërë këtë, por një nga komentet e
9 ngritura është që po t'ju bëja unë po të njëjtën pyetje për
10 krimet kundër njerëzimit, a është qëndrimi juaj që ju keni
11 prova të reja të cilat nuk i keni pasur më parë kur keni qenë
12 në Tribunalin e Hagës? Pra a keni prova të reja për të treguar
13 që konflikti ka ekzistuar dhe ka qenë më i gjerësishëm se ai i
14 Tribunalit të Hagës, apo ka ndonjë shtrirje gjeografike të
15 ndryshme që ju kanë çuar ju në përfundim të ndryshëm, apo po
16 thoni që Tribunali i Hagës thjesht ka gabuar?

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit. Më lejoni të jap një
18 qëndrim të përgjithshëm lidhur me këtë, i nderuar Gjykatës,
19 pasi vlen edhe për datën e fillimit të konfliktit edhe të
20 përfundimit të tij.

21 Prokuroria nuk i përmbahet qëndrimit që gjykatësit e
22 mëparshëm kanë gabuar. Ne e dimë që konkluzionet në të cilat
23 kanë arritur Trupi Gjykses janë bazuar mbi dëshmitë e asaj
24 kohe dhe analizën e tyre dhe kjo në bazë të mënyrës së
25 paraqitjes së argumentimit të asaj çështje penale.

1 Dhe për sa i përket qëndrimit të një prokurori të
2 caktuar, nuk e kam këtë dokument, nuk e di. Nuk e di çfarë
3 dokumenti përmend z. Mishetiç, që thotë që mbi të është
4 arritur një konkluzion i caktuar. Por, për të nënvizuar atë që
5 po them, është që konkluzionet janë arritur në bazë të fakteve
6 të paraqitura në çështjet penale, kontekstit në të cilët janë
7 shqyrtuar ato.

8 Për shembull, u përmend çështja penale kundër
9 Millosheviçit, i cili arriti në përfundimin e gjerësishëm që
10 nuk ishte jo vonë se në verë, por ky ishte në kontekstin e një
11 aktakuze e cila nuk fliste për një konflikt të armatosur. Ata
12 kanë arritur në një përfundim që nuk ka pasur nevojë të
13 paraqiten dëshmi dhe kjo ka çuar në përfundimin që nuk është e
14 nevojshme që të arrihet në një konkluzion.

15 Në çështjen Djordjevic bëhet fjalë për akuza të cilat
16 janë nga janari deri në qershor të vitit 1999. Dhe dëshmitë
17 janë paraqitur pikërisht në kuadrin e kësaj çështjeje penale
18 të ndryshme nga ajo ku tërësia e çështjeve ishte e ndryshme.

19 U përmend edhe çështja penale kundër Limajt. Interesante
20 edhe kjo, pasi konkluzioni që u arrit atje ishte që kishte
21 ekzistuar një konflikt i armatosur, jo më vonë se - ose të
22 paktën - nga fundi i majit dhe kjo ishte në kuadrin e një
23 çështjeje penale në të cilën aktakuza përmendte konfliktin e
24 armatosur që kishte ekzistuar në maj. Në arritjen e këtij
25 përfundimi që ka ekzistuar një konflikt i armatosur përtej

1 dyshimit të arsyeshëm, atëherë gjykimi në rastin e Limaj ka
2 analizuar disa ngjarje të mëhershme. Ka vërejtur që ka pasur
3 disa sulme sporadike në vitin 1997 dhe më pas nënvizoi sulmet
4 e tjera që kanë ndodhur nga fillimi i shkurtit, fillimi i
5 marsit. Forcat ndërkombëtare e kanë vërejtur që aty ka qenë
6 pika e kthesës në zhvillimin e konfliktit në Kosovë.

7 Pra, po të lexoni këtë çështje penale shihni që Trupi
8 Gjykues në rastin Limaj ka arritur në përfundimin se ky ishte
9 momenti kur kishte filluar konflikti.

10 Dhe për sa i përket pikës së kthesës, përmend dosjen e
11 Mbrojtjes së Thaçit, paragrafët 37 dhe 38, ku flitet për
12 shkallëzimin që kishte ardhur si rezultat i sulmeve sporadike
13 të filluara në vitin 1994 dhe siç do të provohet gjatë
14 argumenteve tona, është intensifikuar në mënyrë të fuqishme
15 nga viti 1997. Kështu që ka bërë të mundur që në vitin 1997
16 UÇK-ja të ndërmernte një sulm të sinkronizuar kundër 12
17 stacione policore në zona të ndryshme gjeografike.

18 Mbrojtja e Thaçit ka përmendur armë, sulme ushtarake të
19 periudhës të janarit dhe të shkurtit, në të cilët janë vrarë
20 24 civilë dhe qindra të tjerë janë torturuar, sipas dosjes së
21 tyre dhe paragrafi 39 më pas flet për një pikë kthese në
22 fillim të marsit. Po kështu edhe në çështjen Kordiç, që është
23 e ngjashme, me sa më kujtohet mua. Trupi Gjykues ka arritur në
24 është përfundimin që ka pasur një konflikt të armatosur në
25 prill të vitit 1993 dhe ngjarjet e vitit 1993 ishin të

1 ngjashme me ato të janarit dhe të shkurtit të vitit 1998 në
2 Kosovë.

3 Për sa i përket përfundimit të konfliktit, kjo është në
4 dosjen tonë. Kjo mund të gjendet edhe në vendimin e
5 konfirmimit, por si përgjigje tani mund të them që pala
6 mbrojtëse duket sikur po mbështeten në marrëveshje e
7 demilitarizimit, të transformimit dhe në komente apo
8 jurisprudenca të tjera dhe në fakt duhet që të tregohet kujdes
9 për sa i përket mbështetjes në këto dokumente, për arsye
10 historike, pasi bëhej fjalë për UÇK-në, e cila nuk donte të
11 çmilitarizohej, të zbatonte marrëveshjet ndërkombëtare dhe do
12 të shihet që edhe nga shtatori i vitit 1998 ka pasur njoftime
13 që forcat serbe kanë arritur në kufi dhe njoftime se si një
14 gjeneral serb ka deklaruar se ishin të gatshëm që të
15 ktheheshin për ta rifilluar konfliktin.

16 Faleminderit.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkurtimisht, z. Tieger,
18 ajo që po kuptoj nga ju, pra një nga gjërat që po kuptoj,
19 është që Trupi Gjykses do të duhet të presë dhe të përgatitet
20 në fakt që do të paraqisni provat e ekzistimit të konfliktit
21 përpara datave që ka paraqitur z. Emmerson dhe deri në
22 shtator. Pra, do të paraqisni këtu dëshmi lidhur me
23 vazhdimësinë e konfliktit të cilin e kundërshton pala
24 Mbrojtëse?

25 Z. TIEGER: [Përkthim] Po, kështu është.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe tani kam një pyetje të
2 ngjashme me krimet kundër njerëzimit. Nuk e di z. Tieger, nëse
3 ju do t'i përgjigjeni kësaj.

4 Unë edhe tani nuk po kërkoj që të flisni mbi themeltësinë
5 e dëshmive lidhur me këtë çështje. Pyetja është e thjeshtë:
6 janë dy akte gjykimi, të cilat pala mbrojtëse do t'i
7 shfrytëzojë, jam i sigurt. Pra, aktgjykime të Tribunalit të
8 Hagës, në të cilat është arritur në përfundimin që nuk ka
9 pasur sulme sistematike apo të gjerësishme në atë kohë dhe ajo
10 që duam të dëgjojmë nga ju është se cili është qëndrimi juaj
11 lidhur me këto përfundime apo sugjeroni edhe në këtë rast që
12 nuk duhet të shfrytëzohet konkluzionet, për shkak se ato janë
13 arritur në kuadrin e një periudhe kohore apo gjeografike të
14 ndryshme, apo mendoni ju se një trup tjetër gjykues do të
15 kishte arritur në konkluzion të ndryshëm, apo konkluzioni i
16 tretë që Tribunali i Hagës ka gabuar jo vetëm një herë po dy
17 herë në fakt.

18 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 Pika e parë është se, për sa i përket çështjes penale
20 kundër Haradinajt dhe Limajt, nuk di se sa e preferoni, por në
21 fakt për këtë bëhet fjalë. Në çështjen Haradinaj nuk është
22 bërë përpjekje për ta trajtuar çështjen sistematike, nëse
23 ishte sulm sistematik apo i gjerësishëm kundër një popullate.
24 Pra, është një çështje e rëndësishme, pavarësisht se nuk është
25 trajtuar në atë mënyrë.

1 Në çështjen penale kundër Limajt, konkluzioni ishte që
2 nuk kishte dëshmi që të mbështesë faktin që ka ekzistuar një
3 sulm i gjerësishëm, por ka pasur dëshmi që kanë provuar që ka
4 qenë sulm sistematik. Pra, edhe provat e paraqitura nuk kanë
5 bërë të mundur që të arrihet në përfundimin që ka pasur sulm
6 sistematik mbi popullsinë civile. Pra, ishte një formulim pak
7 a shumë i ndryshëm, më i gjerësishëm. Këto çështje, dhe
8 përfundimi, janë arritur mbi bazën e disa fakteve dhe dëshmive
9 të veçanta të dëgjuara mbi këtë çështje dhe do t'ju paraqesim
10 juve dëshmi të tjera të cilat nuk janë dëgjuar në kuadrin e
11 atyre çështjeve penale. Pra, është një çështje konteksti dhe e
12 fushëpërfshirjes, konkluzione të ndryshme për shkak të tyre.

13 Jurisprudenca e Tribunalit të Hagës dhe jurisprudencat e
14 tjera janë bazuar mbi vlerën provuese, si të thuash, ndriçuese
15 të dëshmive, ndërkohë që tani bëhet fjalë për një trajtim
16 paksa të ndryshëm. Tani mund të shihet një krim që mund të
17 duket që është krejtësisht i izoluar dhe mund të shihet që ka
18 pasur një vend të caktuar ku ka ndodhur një krim, por nuk
19 arrihet dot në përfundimin, ndërkohë që po ta zgjerosh
20 fushëpërfshirjen dhe fushëveprimin që të përfshijë një zonë të
21 tërë gjeografike dhe të paraqiten faktorë sqarues, ndriçues,
22 konkluzionet mund të jenë të ndryshëm.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Tieger.

24 Edhe një herë nuk i kërkoj z. Mishetiç, apo avokatëve të
25 tjerë që të trajtojnë faktet e çështjes penale por a keni

1 ndonjë reagim për të bërë lidhur me këtë parashtrim që sapo
2 është bërë?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës Mettraux,
4 z. Tieger më përmendi mua në parashtrimet e tij. Unë nuk kam
5 në dorë vlerësimet e brendshme të zyrës së ZPS-së por kam
6 prova që kanë paraqitur ata lidhur me ekzistencën e konfliktit
7 të armatosur pasi ka qenë pjesë e dosjes paraprake. Dhe mund
8 ta lexoni vetë, por ky është një material i cili ka qenë në
9 dispozicion të Tribunalit të Hagës dhe të Human Rights Watch.
10 Në Tribunalin e Hagës ishin dëgjuar që në vitin 2005, kur ka
11 pasur një konferencë të KFOR-it, pra në qershor të vitit 1999,
12 që është dëgjuar ky konkluzion, edhe nga Radio Evropa e Lirë.
13 Pra, nuk janë këto dëshmi të reja që kanë ardhur pas vitit
14 2010, për të demonstruar ekzistencën e konfliktit të
15 armatosur.

16 Qëndrimi ynë është që ZPS-ja duhet t'i ketë dëgjuar
17 konkluzionet e mëparshme dhe tani ka arritur në një konkluzion
18 të ndryshëm. Fakti është që një Tribunal Ndërkombëtar i
19 krijuar mbi bazën e Kapitullit të 7 të Këshillit të Sigurimit
20 të Kombeve të Bashkuara, ai i ka hetuar këto krime dhe nuk i
21 ka hetuar ato për shkak se nuk ka pasur konflikt të armatosur.
22 Pra, është konkluzioni i tyre që ata kanë gabuar apo që kanë -
23 - bazuar mbi të njëjtat prova, asnjë gjykatës i arsyeshëm nuk
24 do të kishte arritur në këtë përfundim.

25 Për sa i përket çështjes së sulmeve të gjerësishme apo

1 sistematike, ne i besojmë konkluzioneve të arritura nga
2 Tribunali i Hagës dhe mendojmë që këto janë të rëndësishme,
3 pra që këto elementë nuk kanë ekzistuar. Në përfundimin që ka
4 arritur Trupi Gjykses në rastin Limaj, ata kanë shqyrtuar
5 krimet në një zonë të caktuar gjeografike. Nga paragrafi 209 i
6 aktgjykimit të asaj çështjeje ata janë në fakt përpjekur për
7 t'i trajtuar krimet në kontekstin e raportit të Human Rights
8 Watch lidhur me krimet në përgjithësi në Kosovë. Dhe në
9 paragrafin 10 [sipas përkthimit] ka arritur në konkluzionin
10 që:

11 "Historia konfirmon, fatkeqësisht, që krimet e luftës do
12 të ndikojnë mbi civilët. Pavarësisht kësaj, Trupi Gjykses edhe
13 nëse do ta pranonte që këto sulme, apo civilë, pavarësisht të
14 cilës etnie, janë rrëmbyer nga UÇK-ja dhe këto rrëmbime do të
15 shihen në kontekstin e tërësishëm të Kosovës ku numri ka qenë
16 i vogël".

17 Dhe këtu bëhet fjalë për çështje të cilat janë gjykuar
18 ose në Tribunalin e Hagës ose në gjykatat e Kosovës. Në fund
19 të fundit ju shihni se cila është shifra totale, shifra që
20 është më e lartë se 150, si ka qenë në rastin Limaj, me qëllim
21 që të arrihet në konkluzionin që bëhet fjalë për një
22 proporcion të theksuar të popullatës së Kosovës. Ndërsa për sa
23 i përket përkufizimit si sulm sistematik, për sa i përket
24 kësaj çështjeje, Trupi Gjykses ka arritur në përfundimin që
25 nuk ka pasur sulm kundër popullatës civile në vetvete.

1 Në paragrafin 215 konkluzioni është që personat të cilët
2 janë sulmuar janë ata të cilët janë perceptuar si
3 bashkëpunëtorë, por citoj që UÇK-ja nuk ka pasur një politikë
4 të luftës kundër civilëve në vetvete dhe ky është konkluzioni
5 që është arritur në çështjen Limaj për sa i përket kësaj
6 çështjeje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
8 z. Mishetiç.

9 Z. Emerson, a keni gjë për të shtuar?

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nja dy komente te shkurtra.

11 Së pari, ndoshta po them atë që është krejtësisht e
12 qartë, por bazuar mbi diskutimin që patëm këtu për sa i përket
13 fillimit dhe fundit të konfliktit, këto janë çështje të
14 rëndësishme, pasi në qoftë se kanë bazë të arsyeshme që ZPS-ja
15 të demonstrojë që ka ekzistuar një sulm i gjerësishëm dhe
16 sistematik, i cili të jetë krim kundër njerëzimit, sipas
17 aktakuzës, ne do të thoshim që Trupi Gjykses aktual do të
18 arrijë në konkluzionin që nuk ka juridiksion për të trajtuar
19 ngjarje që nuk përfshihen në periudhën e aktakuzës apo të
20 konfliktit në fakt.

21 Dhe nuk di nëse kjo është në fakt ajo që ka motivuar ZPS-
22 në që të shkojë kundër rrymës së konkluzioneve të të tjerëve,
23 dhe më duke se z. Tieger nuk po i përmbledh si duhet
24 konkluzionet e çështjes Limaj apo Haradinaj. Bëhet fjalë për
25 dy çështje penale kundër të cilave nuk është apeluar nga ana e

1 Prokurorisë. Në fakt ka ekzistuar një apel kundër disa pikave
2 të aktakuzës, në rastin e Haradinajt, por Prokuroria asnjëherë
3 nuk arriti në përfundimin që përfundimet e Trupit Gjykses
4 ishin të gabuara.

5 Megjithatë, provat e çështjeve penale nuk janë të
6 ndryshme në themel. Duhet të krahasohen dëshmi të paraqitura
7 atje me dëshmitë në Limaj dhe Haradinaj.

8 Por kur z. Tieger thotë që Trupit Gjykses atyre çështjeve
9 i janë paraqitur -- dhe krimeve të tyre, aktakuzave, dhe është
10 e rëndësishme që ky Trup Gjykses të shohë nëse ka një model,
11 në fakt ky është një gabim pasi nuk ka ndodhur kjo në ato dy
12 çështje penale.

13 Përveç atyre pasazheve të cilat u janë paraqitur juve, të
14 paragrafëve në rastin Limaj, paragrafi 228 i asaj çështjeje
15 është shumë i qartë, aty Trupi Gjykses thotë qartësisht që:

16 "...Trupi Gjykses konstaton që nuk ka pasur sulm kundër
17 popullatës civile, serbe apo shqiptare qoftë. Në kuptimin e
18 diskutuar pak më herët në aktakuzë, nuk është provuar nga
19 Prokuroria që aktet e tre të akuzuarve, të cilat pretendohet
20 që janë krime kundër njerëzimit, sipas aktakuzës, ishin pjesë
21 e një sulmi të gjerësishtëm apo sistematik..."

22 Pra, nuk është sulmuar popullata civile, nuk ka pasur
23 sulme sistematike apo të gjerësishtëm, pra ky është modeli me
24 të cilin janë vlerësuar pika të aktakuzës. Z. Tieger po
25 përpiquej t'ju bindte se ka ndodhur ndryshe, që ato kanë parë

1 pikat aktakuzës dhe kanë arritur në këtë konkluzion. Por është
2 e qartë që ata kanë pasur në dispozicion të gjitha mjetet për
3 të vlerësuar sjelljen dhe krimet e pretenduara kundër
4 popullatës civile në tërë territorin e Kosovës, gjatë të
5 gjithë kohës që përfshinte aktakuza.

6 Në rastin e Haradinajt dhe Limajt, janë dy zona të
7 ndryshme të Kosovës dhe në të dyja duhet të shihet e gjithë
8 gjeografia. Në rastin e Limajt nuk janë paraqitur dëshmi që të
9 dëshmojnë që UÇK-ja ka sulmuar popullatën civile, pasi nuk
10 ishte kjo në thelb të veprimtarisë së tyre. Dhe ky ishte
11 ndryshimi me rastin Milutinovic dhe Djordjevic, ku u tha që
12 forcat e kombinuara serbe e kanë bërë një gjë të tillë,
13 ndërkohë që UÇK-ja nuk e ka bërë një gjë të tillë. Dhe gjatë
14 kësaj në rastin Haradinaj, gjykatësi arriti pak më tej dhe
15 bazuar me të njëjtat prova dhe paragrafi 122, nuk do ta lexoj
16 por konkluzionet e Trupit Gjykses atje ishin që nuk ka pasur
17 sulm mbi popullatën civile, pra nuk ishte e domosdoshme të
18 bëhej pyetje fare nëse bëhet fjalë për sulm të gjerësishëm apo
19 sistematik pasi nuk ka ekzistuar një sulm mbi një popullatë
20 civile, si premisë fillestare. Pra dy Trupe Gjykesese, pasi
21 kanë shqyrtuar të tërë dëshmitë mbi të cilën do të shfrytëzojë
22 edhe ZPS-ja, arriti në përfundimin që UÇK-ja nuk ka pasur
23 politikë për të sulmuar popullatën civile.

24 Dhe z. Tieger ka barrën e qartë për të treguar se për
25 çfarë flitet në përgjithësi, pasi si modele të veprimit kanë

1 qenë të njëjta atje dhe këtu. Ai duhet të na tregojë se cili
2 është ndryshimi i atyre çështjeve penale dhe kësaj çështjeje
3 këtu, nga pikëpamja e ligjshmërisë. Ai duhet të gjejë se cilat
4 janë këto ndryshime dhe ju të vlerësoni, të nderuar Gjykatës,
5 këtë çështje, se për ndryshe ne po harxhojmë kohën dhe burimet
6 që ka kjo Gjykatë këtu. Pra, këtu bëhet fjalë për pretendime
7 të krimeve të luftës apo krimeve kundër njerëzimit, në të
8 njëjtën periudhë kohe, pasi po të ishte kjo e vërtetë atëherë
9 do t'ja vlente por në këtë rast, në qoftë se Prokuroria
10 vazhdon të vazhdojë me pretendimet e krimeve kundër
11 njerëzimit, apo me prova që të provojnë që UÇK-ja ka pasur
12 këtë synim, do të jetë humbje kohe.

13 Ne kjo do të na çojë në diskutimin e çështjeve të cilat
14 janë -- nuk qenë në periudhën e përkufizuar të konfliktit.

15 Me gjithë respektin që kam për z. Tieger, përgjigjet që
16 dha ai nuk ishin të qarta dhe nuk arrijmë ta kuptojmë. Ai nuk
17 i ka karakterizuar siç duhet autoritetet ligjore në këtë
18 drejtim dhe për sa i përket ZPS-në në përgjithësi, nuk kanë
19 plan të qartë mbi paraqitjen e argumenteve të tyre.

20 Sigurisht, për sa i përket -- kronologjia është e gabuar
21 këtu, pasi duhet të kemi pika të qarta të fillimit e të
22 përfundimit të konfliktit edhe të këtij gjyqi.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj, z. Emmerson.

24 z. Ellis a keni gjë parashtrim për të bërë?

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kam gjë për të shtuar.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam edhe disa pyetje të
2 tjera për ZPS-në. Z. Tieger, besoj se do t'i përgjigjeni
3 përgjigjes -- apo të jepni kundërpërgjigjen tuaj?

4 Z. TIEGER: [Përkthim] E di që ju doni të kaloni në pikë
5 tjetër por dua të përmend një nga çështjet që ngriti z.
6 Emmerson dhe z. Mishetiç për sa i përket konkluzioneve të
7 Limajt, të cilat unë po i injoroj. Pra të asaj që nuk ka
8 ekzistuar një politikë e cila të ketë lidhje me çështjen --
9 problematikat apo pikat e kësaj çështjeje penale.

10 Në fakt, aktakuza e Limajt pretendonte sulme të
11 gjerësishme dhe sistematike kundër popullatës civile serbe dhe
12 bashkëpunëtorëve shqiptarë dhe Trupi Gjykses në Limaj arriti
13 në përfundimin që nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme për të
14 treguar që nuk ka ekzistuar një sulm i gjerësishëm dhe
15 sistematik mbi popullatën serbe por arrit në paragrafin 216,
16 që:

17 "Trupi Gjykses pranon që ka ekzistuar dëshmi të
18 ekzistencës së një politike të UÇK-së për të luftuar kundër
19 bashkëpunëtorëve kosovarë shqiptarë të perceptuar si të
20 tillë."

21 Në paragrafin 217 ka thënë që:

22 "Efekti ishte për të treguar që UÇK-ja ka pasur një
23 politikë që të sulmonte ata që kishin lidhje me regjimin
24 serb."

25 Dhe më pas thuhet që: "Ekzistenca e burgut të

1 Llapushnikut e ka treguar pikërisht politikën e luftimit të
2 bashkëpunëtorëve”.

3 Pra, e nënvizoj edhe një herë këtë çështje. Ju kërkoj
4 ndjesë që po përmend edhe një herë tjetër.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ka nevojë të kërkon
6 falje. Përgjegjësia juaj është e qartë se cilat janë çështjet
7 për të cilat po kundërshtojnë ekipet e Mbrojtjes.

8 Të kalojmë te çështja e përgjegjësisë komanduese. Kam tre
9 pyetje në lidhje me argumentet apo pretendimet që bëni në
10 lidhje me të katër të akuzuarit dhe thjesht këto pyetje kanë
11 për qëllim që të hedhin dritë në ato pretendime. Në qoftë se
12 keni dëshirë që këto çështje t’i trajtoni më vonë, nuk është
13 problem me ne. Mund t’ua mundësojmë këtë.

14 Pyetja e parë ka të bëjë se si e argumentoni çështjen
15 tuaj në lidhje me katër të akuzuarit, pra si janë të lidhur
16 ata mes vete. Me fjalë të tjera, a jeni duke pretenduar se të
17 katërt të akuzuarit ishin eprorë të të tjerëve apo se secili
18 prej tyre është përgjegjës për vartësit e vetë dhe nuk
19 paraqisni pretendimin në lidhje me një raport varësie midis
20 vetë të katër të akuzuarit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

22 Mënyra se si është argumentuar çështja e Prokurorisë, çdo
23 i akuzuar për mendimin tonë ka kontroll efektiv mbi kryerësit
24 e drejtpërdrejtë të krimeve të paraqitura në aktakuzë. Në
25 aktakuzë pretendohet se të akuzuarit kanë ushtruar kontroll

1 efektiv mbi anëtarët dhe instrumentet në NPK. Ky është një
2 term i përkufizuar në paragrafët 55 deri në 57 të aktakuzës.

3 Ne duhet të përpigemi të provojmë se të gjithë të
4 akuzuarit kishin autoritet mbi strukturat e UÇK-së dhe të
5 qeverisë së përkohshme të Kosovës të asaj kohe, dhe kontroll
6 efektiv mbi ato struktura.

7 Argumentimi ynë përfshin të gjithë periudhën e aktakuzës
8 edhe pse të akuzuarit kanë nivele të ndryshme autoriteti,
9 madje edhe midis vetes dhe ne do të dëgjojmë prova në lidhje
10 me këtë. Sidomos duke u nisur nga pozitat e tyre brenda
11 qeverisë së përkohshme të Kosovës, ka krime që janë paraqitur
12 në aktakuzë, për të cilat është e nevojshme autoriteti i
13 domosdoshëm në mënyrë që ato të paraqiten në aktakuzë.

14 Duhet që të vlerësohet se si lidhen faktet midis
15 autoritetit nën UÇK dhe qeverinë e përkohshme të Kosovës. Çdo
16 i akuzuar gjatë kohës së aktakuzës ka pasur kontroll efektiv
17 mbi kryerësit e drejtpërdrejtë gjatë gjithë periudhës dhe kjo
18 bie nën teorinë e përgjegjësisë komanduese.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, ju
20 përgjigjët edhe pyetjes së dytë që kisha.

21 Pyetja e tretë ka të bëjë me paragrafin 52(b) të
22 aktakuzës dhe në qoftë se ju duhet kohë që ta gjeni nuk është
23 problem. Është një pretendim i përgjithshëm që e bëni përsëri
24 në lidhje me të katër të akuzuarit. Ka të bëjë me mosveprimet
25 apo mosmarrjen e masave për raportimin e kryerjes së krimeve

1 të mundshme nga anëtarë të NPK-së autoriteteve përkatëse.
2 Sipas jush cilat janë këto autoritete të cilëve të akuzuarve u
3 është dashur t'u raportonin apo të cilëve nuk u kanë
4 raportuar?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj që e keni fjalën për
6 paragrafin 57(b) të aktakuzës, apo jo?

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Fjala është për autoritetet
9 përgjegjëse brenda UÇK-së të cilat kanë për detyrë
10 disiplinimin e ushtarëve dhe marrjen e masave ndëshkuese për
11 shkeljet e kryera prej tyre. Në paragrafin 712 (d): "çdo i
12 akuzuar ka pasur për detyrë që të informojë autoritete
13 përkatëse brenda strukturave që i kishin krijuar vetë, ose
14 jashtë UÇK-së".

15 Pra, kur bëhet fjalë për autoritetet jashtë UÇK-së, bëhet
16 fjala për autoritetet që u vendosën në Kosovë pas qershorit të
17 vitit 1999. Pra, bëhet fjalë për krimet e kryera edhe para
18 edhe mbas kohës së vendosjes së autoriteteve ndërkombëtare në
19 Kosovë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përgjigja juaj me fjalë të
21 tjera, pjesa e fundit sugjeron se një epror, në qoftë se
22 supozojmë se është epror, sipas doktrinës së përgjegjësisë
23 komanduese, ka një përgjegjësi që t'i raportojë palëve të
24 treta, në qoftë se keni referenca të burimeve ligjore në
25 lidhje me këtë që parashtroni, atëherë do t'ju kisha lutur që

1 të mi jepni këto referenca.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Mund t'ju përgjigjem tani dhe në
3 qoftë se ju intereson më tej, mund t'ju paraqesim edhe
4 referencat ligjore.

5 Aktgjykimi i apelit Popovic, paragrafi 1929 flet për
6 përgjegjësinë e raportimit të autoriteteve të përshtatshme, në
7 raste kur komandanti e di që autoritete të tilla nuk
8 funksionojnë. Në Popovic thuhet si vijon:

9 "Në qoftë se një epror e di që autoritet përkatëse nuk
10 funksionojnë dhe nëse e dinë që një autoritet do të fillojë
11 një hetim që nuk është hetimi i mirëfilltë, atëherë kjo
12 nënkupton se një raport i tillë nuk do të ishte i mjaftueshëm
13 për t'i përmbushur detyrimet e ndëshkimit të kryerësit."

14 Pra në qoftë se -- komandanti nuk mund të ngrejë duart e
15 të thotë se "nuk kam çfarë të bëj" por duhet të bëjë hetime në
16 qoftë se ka një autoritet të përshtatshëm ku mund t'i
17 raportojë ato shkelje.

18 Pra, për kuptimin tonë ky autoritet mund të jenë forcat e
19 ndërkombëtare.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Kehoe?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të ndërlihem me atë çështjen e
23 fundit që ngritët në paragrafin 57 (b). Ju siç dëgjuat, të
24 nderuar Gjykatës, nga 10 qershori, me rezolutën e Kombeve të
25 Bashkuara, i gjithë korpusi ligjor nga Kosova u mor nga Kombet

1 e Bashkuara. Pra, Kombet e Bashkuara ishin përgjegjëse për
2 ligjin dhe rendin në Kosovë.

3 Këtu po injorohet fakti që Kombet e Bashkuara kishin
4 kontroll efektiv nga 10 qersori i vitit 1999 dhe rezoluta e
5 Kombeve të Bashkuara është shumë e qartë se Kombet e Bashkuara
6 janë përgjegjëse nga ajo datë. Pra, ku futet kjo në kontekstin
7 e përgjegjësisë për të marrë masat e duhura për raportimin e
8 krimeve të kryera nga vartësit?

9 Kjo nuk merret aspak parasysh në aktakuzën që e kemi
10 përpara. Atë pyetjen e parë e fut në aktakuzë në kuadër të
11 konfliktit të armatosur kurse ato dy të tjerat që përmendët,
12 ju të nderuar Gjykatës, në kuadër të autoriteteve
13 ndërkombëtare.

14 Për sa i përket çështjes së përgjegjësisë komanduese dhe
15 eprorë, do t'ju jap fjalën z. Mishetiç.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Gjykatës Mettraux, unë shfrytëzoj
17 të drejtën për t'ju kundërpërgjigjur asaj që tha Prokurori dhe
18 më vonë. Siç e dini edhe vetë, një nga elementët e
19 përgjegjësisë komanduese është edhe raporti epror-vartës dhe
20 ne duhet ta dimë se kush është eprori e kush është vartësi në
21 periudhën e caktuar, brenda periudhës që mbulon aktakuza, në
22 mënyrë që ne t'ju kuptojmë siç duhet parashtrimet e
23 Prokurorisë. Gjithashtu dua që të theksoj pa dhënë shumë
24 hollësi, kam një përgjigje për Gjykatësin Barthe dhe këtë
25 përgjigje mund ta bëj kur Trupi Gjykes të jetë i gatshëm.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund ta bëni tani
2 përgjigjen.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne pranojmë propozicionin siç
4 është konstatuar në protokollin shtesë 2 se personat që mbahen
5 në ndalim në lidhje me një konflikt të armatosur, vazhdojnë të
6 jenë të mbrojtur në kuptimin që duhet të lirohen në përfundim
7 të atij konflikti të armatosur.

8 Mirëpo në këtë rast konkret ka një dallim të
9 konsiderueshëm midis dikujt që ka qenë i ndaluar përpara datës
10 20 qershor dhe dikujt që është mbajtur pas kësaj date.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.
12 Urdhëroni, z. Emmerson.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pika të shkurtra.

14 Raporto epror-vartës: pa dyshim që të ketë një
15 përgjegjësi komanduese duhet të ekzistojë raporti epror-
16 vartës. Duhet të ekzistojë dijenia për kryerjen reale apo të
17 mundshme të krimeve dhe përgjegjësia për marrjen e hapave të
18 duhur për ndëshkimin e kryerësve, apo parandalimin e tyre.

19 Ky kategorizim, për mendimin tonë, nga ana e Prokurorisë,
20 ka një defekt. Është referenca që i bën aktgjyqimit Popovic,
21 sepse aty trajtohet një strukturë komanduese tjetër. Në këtë
22 çështje kemi të bëjmë me krijimin e strukturave, ashtu siç
23 kanë qenë, përpara fillimit të vetë luftës.

24 Filluan të ekzistojnë gjatë vitit 1998 dhe departamenti
25 ligjor apo i drejtësisë u krijua në vitin 1998, pra ai i UÇK-

1 së, mirëpo për sa i përket vetë funksionimit apo aftësisë së
2 këtij organi për të kryer në mënyrë efektive punën e vet,
3 përpara dhe pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, atëherë
4 kemi të bëjmë me një skenar krejtësisht të ndryshëm.

5 Këtë po e them sepse shkalla e organizimit në UÇK është
6 diçka që ndryshoi me kalimin e kohës. Domethënë, fillimisht
7 ishte në fillimet e veta.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] S'ka nevojë të shkoni në
9 hollësi të tjera, z. Emerson, në lidhje me këtë. Thjesht për
10 dy pikat e aktakuzës për të cilat i bëmë pyetjet edhe avokatit
11 të Prokurorisë.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, e kam të qartë, por thjesht
13 sa për t'ju dhënë një kornizë. Për t'i kuptuar gjërat më mirë
14 ju ftoj që të lexoni paragrafët 566, sidomos paragrafin 568 të
15 aktgjyqimit Limaj, ku Trupi Gjykses konstatoi se nuk mund të
16 zbatohet doktrina e përgjegjësisë komanduese për shkak të
17 shkallës së mungesës së organizimit në UÇK.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj që z. Roberts ju
19 harrova gjatë pyetjeve të mëparshme që bëra. Në qoftë se keni
20 ndonjë parashtrim për të bërë, keni fjalën.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju faleminderit.

22 Për sa i përket krimeve kundër njerëzimit, nuk kam shumë
23 për të shtuar pranoj dhe pajtohem me atë që thanë kolegët e mi
24 të mbrojtjes. Mund vetëm të shtoj se në aktgjykimet e
25 Haradinajt dhe Limajt, jo vetëm që sugjerohet që nuk pasur një

1 sulm të përhapur gjerësisht dhe sistematik, por gjithashtu
2 duhet -- edhe në këto gjykatat vendore nuk kanë një rast të
3 tillë. Pra, nuk është vetëm një çështje e shkuarjes kundër një
4 rryme, por është çështje e shkuarjes kundër në tsunami të
5 interpretimeve që kanë bërë gjykatat e tjera lidhur me
6 konfliktin e armatosur.

7 Çmoj atë që tha z. Mishetiç, mbi lidhjen me njoftimin e
8 provave në lidhje me të akuzuarit në lidhje me atë se të
9 akuzuarit kishin kontroll efektiv dhe përgjegjësi komanduese
10 mbi bashkë-të akuzuarit. Kjo nuk është përfshirë në dosjen
11 paraprake dhe në dukje nuk ka një shpjegim të qartë se si, për
12 shembull, një i akuzuar ka ushtruar kontroll efektiv mbi një
13 të akuzuara tjetër. Informacioni që kemi nuk mjafton. Ne na
14 duhet informacion i mëtejshëm që ta dimë se si, kur dhe
15 saktësisht mbi çfarë provash bazohet Prokuroria për të
16 vërtetuar këto akuzua.

17 E dyta, për cilat krime konkretisht, specifikisht thuhet
18 se të akuzuarit ishin përgjegjës si komandantë. Në paragrafin
19 55 të aktakuzës, Prokuroria pretendon që këtu përfshihet jo
20 vetëm forma e kryerjes por edhe formë të tjera të
21 përgjegjësisë penale. Nga ajo që tha z. Halling përpara, unë
22 kuptoj se pretendohet se të akuzuarit se kanë pasur kontroll
23 efektiv mbi kryerës të drejtpërdrejtë. Mirëpo duke marrë
24 parasysh këtë paragrafin 55 të aktakuzës, ne duam të paraqesim
25 kundërshtimet tona për hir të procesverbalit.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

2 z. Ellis?

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne ndajmë kundërshtimin që
4 ngritën ekipet e tjera të Mbrojtja. Mendojnë se qëllimi është
5 të mbahet e megjullt se kush nga të akuzuarit kishte kontroll
6 efektiv dhe mbi cilin bashkë-të akuzuar tjetër, brenda cilës
7 periudhë kohore dhe mbi çfarë faze. Sepse kjo nuk është e
8 qartë në aktakuzë. Ju e dini se për sa i përket përgjegjësisë
9 komanduese, të gjithë e kemi të qartë nga palët dhe mirëpresim
10 paraqitjen e provave.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Kehoe, për sa i përket
12 pyetjes që e parashtruat, e mora shënim dhe do t'ju jap
13 mundësi që të trajtoni paragrafin 45 dhe 61 të dosjeve para-
14 gjyqësore, dhe aty përmendni edhe të ashtuquajturin
15 operacionin patkua.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund t'ju jap një përgjigje në pikat
17 të shkurtra, nëse doni.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit që u ofruat
19 që ta bëni këtë, por unë them jo.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Vetëm një gjë përpara se t'i
21 largohemi përgjegjësisë komanduese, dua të them diçka për
22 çështjen e njoftimit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'kemi shumë
24 kohë. Ju lutem të jeni shkurt.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Në aktakuzë, si Prokurori, kemi

1 detyrimin të paraqesim faktet materiale. Pra, pyetja në qoftë
2 se dikush nga të akuzuarit ishte në vartësi të një të akuzuari
3 tjetër dhe në qoftë se efekti i raportit të drejtpërdrejtë
4 vartës-epror kalon nëpërmjet vartësi ndërmjetësues, të
5 ndërmjetëm.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam disa pyetje për ZPS-në
7 në lidhje me sulmin e përhapur gjerësisht dhe sistematik
8 kundër popullatës civile të kundërshtarëve. Do t'u jap të
9 gjithëve mundësinë që të marrin fjalën.

10 Pyetja për Prokurorinë, në dosjen paraprake, ZPS-ja u
11 referohet krimeve që pretendohen që u kryhen ndaj të
12 ndaluarve, të cilët në atë kohë ishin anëtarë të UÇK-së. A
13 është qëndrimi i ZPS-së se këta të ndaluar bien brenda kuadrit
14 të popullatës civile të kundërshtarëve?

15 Z. QUICK: [Përkthim] Po, qëndrimi i Prokurorisë është se
16 anëtarë të forcave të armatosur të ndaluar në atë kohë, të
17 cilët kanë qenë jashtë luftimeve, nga vetë fakti i ndalimit të
18 tyre, bien brenda kuadrit të popullatës civile të
19 kundërshtarëve. Këtu shpjegohen edhe elementët kontekstuale
20 lidhur me krimet kryer kundër njerëzimit dhe në aktakuzë
21 gjithashtu pretendohet në paragrafin 17, se të gjitha veprimet
22 dhe mosveprimet e paraqitura në aktakuzë, akuzohen si krime
23 kundër njerëzimit dhe janë pjesë e një sulmi të përhapur
24 gjerësisht dhe sistematik kundër të gjithë kundërshtarëve.
25 Pastaj në vendimin e konfirmimit nga Gjykatësi i Procedurës

1 Paraprake, paragrafi 126, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e
2 pranon se një numër i vogël i viktimave të pretenduara nga
3 mesi i popullatës civile të kundërshtarëve, ishin të punësuar
4 apo kishin lidhje me forcat policore dhe ushtarake të Serbisë
5 dhe Jugosllavisë. Dhe për arsye se janë konsideruar apo
6 perceptuar si kundërshtarë, ata përfshihen në atë kategori të
7 popullatës civile të kundërshtarëve. Fakti se individë të
8 tillë mund të jenë viktimë të krimeve kundër njerëzimit,
9 sikurse është gjykuar edhe në aktgjykimin të Apelit të
10 Tribunalit të Hagës në çështjen Matric dhe në tribunale të
11 tjerë, të gjithë individët të cilët nuk janë civilë, mund të
12 jenë viktimë të krimeve kundër njerëzimit.

13 Sidoqoftë, statusi i viktimës ka të bëjë me diçka tjetër,
14 por është faktor relevant në qoftë se në sulm është i drejtuar
15 ndaj kundër popullatës civile. Në aktgjykimin të apelit
16 Blaskic, në paragrafin 115 thuhet se përcaktimi nëse prania e
17 ushtarëve brenda një popullate civile i pamundëson asaj
18 popullate, apo ja heq asaj popullate karakterin e saj civil,
19 varet nga numri i ushtarëve, si dhe nga rrethanat e atyre
20 ushtarëve në atë kohë, pra kjo thuhet në aktgjykimin e apelit
21 Blaskic.

22 Qëndrimi i Prokurorisë është se anëtarët e forcave të
23 armatosura të cilat kanë qenë jashtë luftimeve dhe të cilat
24 janë mbajtur nën ndalim, janë pjesë e popullatës civile të
25 kundërshtarëve.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja ime përqendrohet në
2 anëtarë të cilët ishin anëtarë të UÇK-së në atë kohë të
3 ndalimit të tyre dhe të cilët konsideroheshin si tradhtarë,
4 sipas pretendimeve të akuzave të paraqitura në dosjen
5 paraprahe.

6 Pra, kjo kategori njerëzish a përfshihet brenda nocionit
7 të popullatës civile të kundërshtarëve?

8 Z. QUICK: [Përkthim] Kemi personat që pretendohen se
9 ishin bashkëpunëtorë, pasi kemi personat që perceptoheshin se
10 ishin tradhtarë dhe pastaj kemi anëtarët e UÇK-së të cilët
11 pretendohej se ishin ose bashkëpunëtorë të armikut ose
12 tradhtarë.

13 I takon Trupit Gjykses që të nxjerrë vendim dhe që ta
14 konstatojë nëse këta kualifikohen si civilë. Ajo që është me
15 rëndësi për ne është se ata kanë qenë jashtë luftimeve në
16 momentin e mbajtjes së tyre në ndalim dhe prandaj janë brenda
17 mbrojtjeve që ju siguron drejtësia ndërkombëtare. Të gjithë
18 ata që nuk janë anëtarë të forcave të armatosura, janë civilë,
19 dhe pavarësisht nëse marrin pjesë aktive në luftime ose jo,
20 kjo përcaktohet rast pas rasti, mirëpo ata e humbin statusin e
21 mbrojtjes së tyre si civilë, në qoftë se marrin pjesë në
22 luftime.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ende jam te koncepti i një
24 sulmi të drejtuar kundër personave që janë ushtarë në atë kohë
25 të ndalimit të tyre të UÇK-së ose të forcave të RFJ-së. Nga

1 aktakuza kuptoj se shënjestrohen sepse janë ose anëtarë të
2 forcave sulmuese të serbëve ose sepse janë tradhtarë.

3 Pra, nuk janë viktima të rastit të një sulmi, këto
4 kategori njerëzish. Janë faktikisht caqe apo objektiva të një
5 sulmi. E keni të qartë pyetjen time?

6 Z. QUICK: [Përkthim] Po, mendoj se tani e kam të qartë
7 dhe përgjigja ime është po, qëndrimi i ZPS-së se anëtarë të
8 forcave të armatosura që janë viktima, janë brenda kategorisë
9 së grupit të kundërshtarëve, sikurse përkufizohet në
10 paragrafin 32 të aktakuzës dhe brenda kategorisë së popullatës
11 civile të kundërshtarëve, për sa i përket lidhjes midis
12 aktakuzës kur ajo lexohet si një tërësi. Përkufizimi i
13 kundërshtarëve në paragrafin 32 me pretendimet se të gjitha
14 krimet e akuzuara në aktakuzë janë kryer kundër kundërshtarëve
15 dhe fakti që aktakuzë përfshin disa anëtarë të forcave të
16 armatosura, tregon se këta janë pjesë e akuzave në atë
17 çështje.

18 Më pas, anëtarët e forcave të armatosura që janë
19 arrestuar dhe keqtrajtuar në vendet e njëjta dhe të cilët janë
20 mbajtur të ndaluar dhe të keqtrajtuar në ato vende, janë marrë
21 në pyetje dhe janë keqtrajtuar: të gjitha këto tregojnë se
22 edhe ata kanë qenë një objektiv i një sulmi.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Me këtë më çuat në një
24 pyetje tjetër.

25 Thoni se person që ka qenë objektiv i një sulmi mbi

1 bazën se ka qenë i etnicitetit serb, dhe këtë ju nuk e
2 pretendoni, por të themi sikur të ketë pasur një sulm të
3 përhapur gjerësisht dhe sistematik të drejtuar kundër civilëve
4 serbë ose të ndonjë etniciteti tjetër, a mund të na thoni se
5 cili është dallimi midis atij pretendimi dhe pretendimit që
6 keni bërë ju?

7 Z. QUICK: [Përkthim] Mendoj se ka një dallim sepse
8 popullata civile e kundërshtarëve, siç e kemi përkufizuar në
9 paragrafin 32, i përfshin të gjitha këto kategori. Pra i
10 përfshin personat që perceptoheshin se nuk përkrahnin qëllimet
11 dhe metodat e UÇK-së dhe të qeverisë së përkohshme, dhe
12 gjithashtu këtu përfshihen edhe personat të etniciteteve të
13 tjera, si për shembull të atij serb.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Thjesht ju po thoni se
15 personat sulmoheshin në bazë etnike, pavarësisht që nuk kishin
16 ndonjë lidhje tjetër. A është ky argumentimi juaj?

17 Z. QUICK: [Përkthim] Ata bien brenda kategorisë së
18 popullatës civile të kundërshtarëve sepse serbët -- pretendimi
19 se u sulmuan në bazë të etnicitetit të tyre shkon dorë më dorë
20 me pretendimin se u perceptuan se ishin kundërshtarë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju faleminderit.

22 Urdhëroni, z. Kehoe.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] E kam pak të vështirë ta kuptoj se
24 cili është ky person dhe nuk mund të mbahet në ndalim si pjesë
25 e forcave të armatosura. Qëndrimi është i qartë: në qoftë se

1 merr pjesë në luftime, atëherë je luftëtar dhe mund të
2 ndaloresh, të mbahesh në ndalim. Dhe ta shohim, për shembull
3 konfliktin midis FARK-ut dhe UÇK-së në atë kohë. Atëherë a
4 mund FARK-u të konsiderohet si pjesëmarrës aktiv në luftime?
5 Po. Dhe në atë rast, një anëtar i FARK-ut mund të ndaloher.
6 Por një bashkëpunëtor i cili bashkëpunon me forcat e RFJ-së
7 gjatë gjithë kësaj kohe, gjatë luftimeve, i cili -- pra
8 shtrohet pyetja a ka marrë pjesë aktive apo jo në ato luftime,
9 atëherë përgjigja është po, se mund të ndaloher. Pra në qoftë
10 se merr pjesë aktive në luftime pavarësisht nëse je pjesë i
11 FARK-ut apo i një njësie tjetër të armatosur, apo je një
12 bashkëpunëtor, ti mund të mbahesh i ndaluar sepse përfaqëson
13 apo paraqet një kërcënim për palën tjetër dhe kjo është e
14 qartë. Ajo që nuk është e qartë është se si do ta vërtetojë
15 ZPS-ja këtë në bazë të akuzave që i ka paraqitur në aktakuzë.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pajtohem plotësisht me mënyrën
17 se si u shpreh në emër të z. Thaçi, dhe në fakt, në çështjen
18 Haradinaj, Prokuroria përfshiu akuza, apo pretendime, se
19 kishte konflikte mes dy forcave kosovo-shqiptare, UÇK dhe
20 FARK-u, lidhur me këtë pikë. Eventualisht këto u shkrinë me
21 njëra-tjetrën, në realitet, por Trupi Gjykses në atë çështje
22 gjyqësore e vuri në dukje atë qasje edhe tha që anëtarët e
23 FARK-ut nuk mund të mos [e pakuptueshme] civile në kuadër të
24 krimeve kundër njerëzimit.

25 Por dua të them diçka tjetër, për të sqaruar pozicionin e

1 Prokurorisë, më saktë. Mua më duket sikur termi "popullatë
2 civile e kundërshtarëve" është një term kontradiktues në
3 vetvete, nuk është as koncept juridik. Është një hibrid, po të
4 themi. Një term hibrid, mes pjesës së parë që rrjedh nga
5 krimet e njerëzimit mbi popullatat civile, dhe e dyta që
6 bazohet në qasjen e Prokurorisë për NKP-në, dhe është krijuar
7 ky term, të marra se bashku.

8 Sepse ata janë shënjestruar sepse kanë qenë kundërshtarë
9 por nuk është pjesë e atyre që janë shënjestruar për qëllim të
10 krimeve kundër njerëzimit. Edhe këto janë të gjitha konstatime
11 që janë të qarta, janë diskutuar në çështjen Limaj dhe
12 Haradinaj, kur personat që mbahen për një arsye specifike, jo
13 sepse kanë qenë pjesë e popullatës civile. Ka një dallim të
14 madh kjo, kur bëhet fjalë për ndalimin. Pse kanë qenë arsyet?
15 Cilat kanë qenë arsyet. Në asnjë nga këto raste nuk u
16 konstatua se ishin arsye për krime ndaj njerëzimit.

17 Në thelb, çdo person që merr pjesë në luftime, qofshin
18 këta "anëtarë" të forcave të armatosura, që është shumë e
19 ndërlikuar, në fakt, për grupet e armatosura joshtetërore në
20 një konflikt asimetrik, por si bëhesh anëtar dhe kur nuk je më
21 anëtar dhe kush merr pjesë aktivisht në luftime nga ana
22 tjetër, nuk është civil.

23 Dhe në fakt, rregulla 5 e ICRC-së mbi të drejtën
24 humanitare ndërkombëtare zakonore përkufizon civilët si
25 persona që nuk janë pjesë, apo nuk janë anëtarë të forcave të

1 armatosura. Prandaj, po ju them që ky termi që është marrë për
2 civilët, në këtë rast është një përzierje e dy termave. Këta
3 nuk janë persona që janë anëtarë sa për të marrë një rrogë nga
4 qeveria, por edhe civilët që në mënyrë të drejtpërdrejtë
5 marrin pjesë në luftime, të jemi të qartë këtu. Të gjithë ata
6 që ishin në UÇK-së ishin civilë, që merrnin pjesë në luftime.
7 Nuk ishte ndonjë subjekt shtetëror. Ishin bujq ditën dhe
8 bëheshin ushtarë natën, roje natën.

9 Pra, e njëjta gjë nga ana serbe. Kishte forca që ishin të
10 bërë pjesë, pra ishin forcat paraushtarake dhe kishte edhe
11 civilë serbë që morën të gjithë armë. Pra për t'ju përgjigjur
12 pyetjes, pra, popullata serbe, kundërshtarët serbë, a i
13 përfshinë këta anëtarë apo luftonin ata nga një anë në
14 tjetrën. Kjo nuk është pyetje me vlerë nga pikëpamja juridike,
15 sepse termi "popullatë civile e kundërshtarëve", e
16 kundërshtarë civile, është një term kontradiktor në vetvete,
17 është një term hibrid. Është përfshirë dhe është krijuar për
18 të zgjeruar sa më shumë numrin e personave në aktakuzë, por
19 nga pikëpamja juridike nuk ka asnjë farë kuptimi.

20 Pra, fuqimisht ju inkurajoj ju si Trup Gjykues, t'i
21 kërkoni Prokurorisë ta përkufizojë edhe një herë këtë pjesë sa
22 i takon popullatës civile.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
24 z. Emmerson.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk e di a do të bëjmë

1 pushim në fakt sepse ka edhe z. Ellis apo z. Roberts. Nëse
2 keni -- duhet të flisni patjetër, e bëni tani parashtrimin
3 tuaj ose pas pushimit, përndryshe.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë thjesht doja të thosha që nuk
5 kam ndonjë gjë të madhe për të shtuar. Unë në fakt doja të
6 them që nuk e kuptova fare përgjigjen e Prokurorisë dhe nuk
7 jam i qartë se cili është pozicioni i tyre. Pra unë pajtohem
8 me parashtrimet e z. Emmerson. Unë nuk e kuptoj se cila është
9 çështja e tyre, kështu që do të mirëprisja çdo parashtrim të
10 mëtejshëm në këtë drejtim.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, edhe ne për të
13 njëjtat arsye pajtohem. Aktakuza nuk është shumë e qartë
14 lidhur me këtë aspekt, nuk është përkufizuar siç duhet për
15 këtë pikë.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ka ndonjë gjë z. Laws për të
17 thënë?

18 Z. LAWS: [Përkthim] Jo nuk kam asgjë për të shtuar.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ja jap fjalën përsëri
20 Kryegjykatësit tani.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi kaluar
22 pak kohën dhe kemi pushimin e drekës tani.

23 Për urdhrin ne i kemi marrë parashtrimet tuaja, i kemi
24 shqyrtuar. Do të nxjerrim një urdher tjetër javën tjetër.
25 Sidoqoftë, Mbrojtja ka dashur të diskutojë dy aspekte të tjera

1 që nuk e di në fakt pse nuk i paraqitët me shkrim.

2 Ju z. Kehoe e kishit këtë shqetësim?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Shkurtimisht, një ka të bëjë me
4 Raporterin e Posaçëm Special, dhe çfarë roli luan në mocionin
5 që kemi dorëzuar ne për të marrë deponime. Duam më shumë
6 sqarime lidhur me këtë. Duhet të kisha qenë pak më i qartë
7 mbase në parashtrimet e mia.

8 E kuptoj, i nderuar Gjykatës. Ne duam pak sqarim për këtë
9 pikë. Kur të dorëzojmë një mocion, a ja dorëzojmë Raporterit
10 Special apo juve? Apo është pjesë e Trupit Gjykues e kështu me
11 radhë. Kjo ishte pikëpyetja që kishim ne.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e kemi
13 trajtuar në fakt, por vazhdoni me pyetjen tjetër.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Për protokollin e dëshmitarëve në
15 fuqi, aktualë. Ua thamë edhe herën e fundit. Është një
16 protokoll që është duke u shqyrtuar nga Dhoma e Apelit, por në
17 thelb ishim të sigurt që Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk
18 kishte shkelur detyrat e veta apo diskrecionin në këtë
19 drejtim. Ne kemi qenë në kontakt me dëshmitarët ndërkombëtarë,
20 të lartë, ndërkombëtarë, ushtarakë, të cilët ishin dakord të
21 na takonin por u ndërpre kjo gjë sepse nuk e lejonte
22 protokollin. Prandaj kërkoj që të kemi një zgjidhje për këta
23 dëshmitarë ndërkombëtarë, të cilët shprehimisht janë pajtuar
24 të na takojnë në banesat e tyre. Ju lutem Trupit Gjykues se në
25 ç'formë duhet ta trajtojmë ne këtë dhe gjithashtu lidhet me

1 pikën nëse ZPS-ja do të heqë njerëz nga lista e vet. Të na
2 thotë në kohë të mjaftueshme paraprakisht, në mënyrë që të
3 intervistojmë ata persona sepse nuk do të jenë pjesë e
4 protokollit.

5 Dhe një gjë tjetër: ju thatë që gjuha që do të përdorim
6 këtu është anglishtja. Por klienti më ka kërkuar që të
7 pranojmë përkthimin në anglishte dhe gjykata të ketë kujdes
8 përkthimin e këtij legjislacioni. Ka pasur disa probleme me
9 përkthimin e këtij legjislacioni sa i takon serbishtes, por
10 përkthyesit duhet të përdorin gjuhën e legjislacionit dhe të
11 shohin si është parashtruar në legjislacion.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Laws?

14 Z. LAWS: [Përkthim] Në fakt a mund të ngre edhe unë një
15 çështje? Ju thatë, i nderuar Gjykatës, që Trupi Gjykses do të
16 nxjerrë një urdhër apo do të marrë një vendim lidhur me
17 parashtrimet e ndryshme që janë ngritur.

18 A mund t'ju them sa i takon parashtrimeve të përbashkëta
19 të Mbrojtjes. Parashtrimet që janë ngritur, në paragrafin 9,
20 faqja 3, për pjesëmarrjen e viktimave, dhe janë dy faqe për
21 këtë, ata ngrenë çështje që janë shumë themelore, për çështjen
22 e përfaqësimit të viktimave, dhe unë në emër të viktimave do
23 të doja të më dëgjonin lidhur -- përpara se të marrë vendim
24 Trupi Gjykses.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni të

1 dorëzoni diçka me shkrim apo me gojë?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Të dyja. Edhe me sot mund ta bëj, por
3 edhe mund të dorëzoj një dokument me shkrim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë ju
5 duhet për ta përgatitur këtë dokument, këtë parashtrim?

6 Z. LAWS: [Përkthim] Këtë dokument mund ta përgatisim në
7 fillim të javës tjetër, qysh në fillim të javës tjetër.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, ta
9 diskutojmë tani që kemi pushimin.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Kur themi "javën tjetër", e kam
11 fjalën të hënën.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Bëjmë
13 pushimin e drekës. Kthehemi në orën 14.30. Të përpiqemi
14 të mbarojmë deri në orën 16.00.

15 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.12

16 --- Seanca rifillon në orën 14.30

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, ne e
18 kemi rishqyrtuar kërkesën tuaj. A dëshironi që të bëni
19 parashtrimet tuaja tani gojarisht, me qëllim që të shmangim
20 procesin e të shkruarit?

21 Z. LAWS: [Përkthim] Jam shumë i lumtur ta bëj si të doni.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
23 atëherë.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Ta bëjmë? Dakord.

25 Faleminderit për këtë mundësi për t'ju drejtuar lidhur më

1 këtë çështje.

2 Në dosjen e përbashkët të palëve Mbrojtëse, është
3 propozuar që të modifikohet ajo që ka treguar Trupi Gjykses
4 lidhur me mënyrën se si do të zhvillohet çështja e
5 pjesëmarrjes së viktimave.

6 Është një numër ndryshimesh të cilat do të kenë ndikim të
7 drejtpërdrejtë lidhur me mundësinë e viktimave për të marrë
8 pjesë, si dhe për t'u përfaqësuar nga ana jonë. Dhe arsyeja
9 del kur lexohet me kujdes teksti i propozuar.

10 Por shkurtimisht, kolegët përballë propozojnë si më
11 poshtë, që viktimat që marrin pjesë në proces duhet të japin
12 një lajmërim paraprak të pyetjeve që ata duhet të bëjnë në
13 proces dhe këtë përmes meje, Mbrojtësit të Viktimave dhe unë
14 këto pyetje më pas t'ia kaloj dëshmitarit në kohën e duhur,
15 por të njoftoj edhe Trupin Gjykses lidhur me pyetjet që ata do
16 të bëjnë.

17 Nga ky hap i parë, ato vazhdojnë dhe thonë që duke qenë
18 se ne si Mbrojtës të Viktimave i përfaqësojmë ata si individë,
19 atëherë ne duhet të nxjerrim emrin e viktimave në emër të të
20 cilit bëjmë pyetjet dhe shpresoj që Trupi Gjykses të shikojë
21 që janë dy ndryshime të rëndësishme të propozimeve që ka bërë
22 vetë Trupi Gjykses.

23 E para, që viktimat i bëjnë pyetjet, dhe ne jemi një kuti
24 postare që i kalon me Trupin Gjykses. Dhe e dyta, edhe
25 pashmangshmërisht kjo bën që viktimat me një status të vetëm,

1 pra viktimat të cilët nuk janë dëshmitarë duhet të mos gëzojnë
2 më anonimitetin. Unë dua të them si përmbledhje se e
3 kundërshtojmë fuqimisht këtë. Është një përpjekje e fshehtë
4 për të dëmtuar pjesëmarrjen e viktimave dhe nuk reflekton
5 realitetin e përfaqësimit të viktimave në këtë Gjykatë apo
6 gjetkë. Dhe ajo që propozoj të bëj është ta trajtojmë këtë në
7 dy pjesë.

8 Pjesa e parë është ajo që ka të bëjë me njoftimin e
9 viktimave përmes nesh dhe jo që ne t'i bëjmë pyetjet që
10 mendojmë që janë të përshtatshme dhe t'i bëjmë në emrin e
11 tyre. Më lejoni që t'ju paraqes së pari pikëpamjet tona
12 paraprake lidhur me këtë çështje, në faqen 9, në paragrafin
13 33, Pjesëmarrja e Viktimave.

14 Paragrafi 33 synon të paraqesë një mënyrë të arsyeshme që
15 ne në emër të viktimave të njoftojmë tematikën që duam të
16 trajtojmë, dhe jam dakord me këtë. Dhe thuhet kështu:

17 "Me të marrë listën e dëshmitarëve që do të thirren nga
18 ZPS-ja e pala Mbrojtëse, Mbrojtësi i Viktimave do të njoftojë
19 Trupin Gjykues dhe palët e tjera dhe pjesëmarrësit, se cilët
20 nga dëshmitarë dëshiron të marrë në pyetje."

21 Propozimi i palës Mbrojtëse gjendet në faqen 3, paragrafi
22 10 i dokumentit të përbashkët dhe e kanë ndryshuar formulimin
23 në një mënyrë që është aq dramatike sa edhe paraqitja ime para
24 Trupit Gjykues, që thotë që me të marrë programin e
25 dëshmitarëve që do të thirren nga ZPS-ja për palën Mbrojtëse,

1 avokatët duhet t'i njoftojmë përmes Mbrojtësit të Viktimave,
2 Trupin Gjykses dhe palët pjesëmarrëse të tjerë, se cilët
3 dëshmitarë dëshirojnë që ata të marrin në pyetje, me një
4 përshkrim të përgjithshëm të fushave apo tematikës mbi të
5 cilën dëshirojnë ta marrin në pyetje secilin prej dëshmitarëve
6 dhe të përfshihet më pas një përshkrim i shkurtër.

7 Pjesa e dytë është ajo se cilës duhet t'i rikthehem pas
8 është pjesa e dytë e paragrafit 10, që ka të bëjë me çështjen
9 e anonimitetit të viktimave pjesëmarrëse. Lidhur me pjesën e
10 parë, janë viktimat të cilët e njoftojnë Trupin Gjykses mes
11 nesh lidhur me pyetjet që ata dëshirojnë të bëjnë dhe cilat
12 janë këto pyetje

13 Ne ngremë pyetjen, ku e ka origjinën kjo skemë apo ky
14 komplot dhe mendojmë që vjen nga neni 22(6), i cili nuk përbën
15 bazë ligjore për këtë ndryshim radikal.

16 Po ta lexojmë formulimin e tij me kujdes pasi në
17 paragrafin 11 të parashtrimeve të Mbrojtjes, tregon se ato e
18 kanë riformuluar nenin 22(6) me qëllim që ai të jetë në
19 përputhje me parashtrimin e programit që ata parashtojnë, dhe
20 në paragrafin 11 thuhet që:

21 "Në bazë të nenit 22(6) të Ligjit të Dhomave të
22 Specializuara, viktimat lejohen që të përfaqësohen përmes
23 Mbrojtësit të Viktimave" dhe kjo përshtat tërësisht me atë që
24 thonë që viktimat ju njoftojnë juve përmes nesh, por nuk thotë
25 kështu neni 22(6). Në fakt as nuk është afërsisht ashtu pasi

1 nuk përmenden aty asgjë që të bëhen përmes nesh. Aty thuhet
2 që:

3 "Dhomat e Specializuara mund të lejojnë përfaqësimin e
4 Mbrojtësit të Viktimave në emër të viktimave..."

5 Gjatë Procedurës Paragjyqësore dhe të gjykimit dhe sipas
6 nesh, "në emër të" është një term krejtësisht i ndryshëm nga
7 "përmes". Unë mund të bëj diçka në emër të dikujt, pa marrë
8 asnjë kontribut nga ata. Ndërkohë që asgjë nuk mund të ndodhë
9 përmes meje pa luajtur rol personi i cili synon të më
10 shfrytëzojë mua si përçues.

11 Pra neni 22(6) citohet por nuk përbën --

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Duke dëgjuar këtë ne shohim atë
13 që po thuhet dhe forcën me të cilën po bëhet ky argument. Jemi
14 të gatshëm që ta tërheqim këtë amendament, në mënyrën siç
15 është formuluar ai.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po thoni
17 po e tërheqim.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po e
20 tërhiqni kërkesën.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Amendamenti i propozuar tërhiqet.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

23 Z. LAWS: [Përkthim] E gjithë skema, i gjithë propozimi --
24 dakord, por nuk jam i qartë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha, e

1 tëra?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Ne kishim dy amendamente aty.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I tërhiqni në
4 tërësinë e tij?

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, dhe kthehemi
6 në atë fazë ku jemi dakord ku jemi dakord me propozimin që
7 keni bërë ju, të nderuar Gjykatës.

8 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 Atëherë, z. Laws, kërkesa që është në pritje për
11 pjesëmarrjen e viktimave pjesëmarrëse do të marr; një vendim
12 me datën 15 shkurt.

13 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do t'i
15 kthehemi urdhrave tanë gojorë.

16 I pari që ka të bëjë me afatin për ndryshimin e listës së
17 provave materiale të ZPS-së, i kërkohet që ta dorëzojë listën
18 e ndryshuar me datë brenda 30 janarit të vitit 2023, në orën
19 16.00 me përgjigjet e kundërpërgjigjet, sipas rregullës 76 të
20 Rregullores.

21 Urdhri gojor i dytë, që ka të bëjë me afatin për mocionet
22 e tjera, në bazë të rregullës 117(2).

23 Palët dhe pjesëmarrësit urdhërohen që të dorëzojnë
24 mocionet në bazë të rregullës 117(2) para datës, deri më datë
25 21 shkurt, në orën 16.00.

1 Palët dhe pjesëmarrësit urdhërohen që të dorëzojnë
2 përgjigjet dhe kundërpërgjigjet ndaj këtyre mocioneve, nëse
3 dëshirojnë të bëjnë këtë jo më vonë se 8 shkurti i vitit 2023,
4 ora 16.00 dhe nuk do të pranojmë asnjë kundërpërgjigje.

5 Rregulli [sipas përkthimit] i tretë i cili ka afate për
6 Rregullin 153 dhe 154.

7 ZPS-së i kërkohet që të dorëzojë mocionet e rregullës 154
8 për 12 dëshmitarët e parë, brenda datës 7 shkurt të vitit
9 2023, ora 16.00.

10 Pala Mbrojtëse dhe Mbrojtja e Viktimave kërkohet që të
11 dorëzojnë përgjigjet e këtyre mocioneve nëse dëshirojnë jo më
12 vonë se 20 shkurti i vitit 2023, ora 16.00.

13 Paneli nuk pranon asnjë përgjigje.

14 ZPS-ja kërkohet që t'i dorëzojë mocionet e rregullta të
15 rregullave 153 dhe 154, lidhur me grupin e dytë të 12
16 dëshmitarëve brenda 15 marsit të vitit 2023, ora 16.00.

17 Pala Mbrojtëse dhe Mbrojtja e Viktimave urdhërohen që të
18 dorëzojnë përgjigjet ndaj këtyre mocioneve, nëse dëshirojnë,
19 jo më vonë se 27 marsi i vitit 2023, ora 16.00.

20 Trupi Gjykses nuk pranon asnjë përgjigje.

21 Urdhri i katërt, ka të bëjë me afatin për kërkesat për
22 pjesëmarrjen e viktimave pjesëmarrëse në proces. Sipas
23 rregullës 114, paragrafët (1), (2) dhe (5) të Rregullores,
24 Zyra Administrative kërkohet që të dorëzojë aplikimet për
25 pjesëmarrjen e viktimave, brenda datës 15 shkurt të vitit

1 2023, ora 16.00.

2 Palët kërkohet që të paraqesin mocionet lidhur me bazën
3 ligjore për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e përbashkët, nëse
4 dëshirojnë ta bëjnë një të tillë, jo më vonë se 20 shkurti i
5 vitit 2023, ora 16.00.

6 Paneli nuk pranon asnjë përgjigje.

7 I pesti që ka të bëjë me afatin për mocionin për faktet e
8 gjykuara. ZPS-ja dhe Pala Mbrojtëse urdhërohen që të dorëzojnë
9 mocionet për faktet e gjykuara në bazë të rregullës 127(2),
10 para 1 marsit të vitit 2023, ora 16.00.

11 Palët dhe pjesëmarrësit urdhërohen që të dorëzojnë
12 përgjigjet ndaj këtyre mocioneve para datës 3 prill të vitit
13 2023, ora 16.00 dhe kundërpërgjigjet nuk do të dorëzohen më
14 vonë se 10 prilli i vitit 2023, ora 16.00.

15 Urdhri i gjashtë gojor që ka të bëjë me afatet për
16 mocionin sipas rregullit 155.

17 ZPS-ja urdhërohet që të dorëzojë mocionin e parë të
18 Rregullës 155 para 1 marsit të vitit 2023, ora 16.00.

19 Mbrojtja dhe Mbrojtësja e Viktimave urdhërohen që të
20 dorëzojnë përgjigjet ndaj këtyre mocioneve, nëse dëshirojnë ta
21 bëjnë një gjë të tillë, jo më vonë se 22 marsi i vitit 2023,
22 ora 16.00.

23 ZPS-ja urdhërohet që të dorëzojë kundërpërgjigjen, nëse
24 dëshiron ta bëjë këtë, brenda 29 marsit të vitit 2023, ora
25 16.00.

1 Urdhri gojor i shtatë, që ka të bëjë me datën për
2 Konferencën Përgatitore të Prokurorit të Specializuar dhe
3 fillimin e gjykimit.

4 Trupi Gjykses cakton datën për fillimin e gjyqit me datë
5 22 mars të vitit 2023, në qoftë se nuk ka rrethana
6 përjashtimore.

7 Konferenca Përgatitore e Prokurorit të Specializuar do të
8 mbahet më datën 17 shkurt të vitit 2023.

9 Urdhri i tetë që urdhëron ZPS-në që të tregojë një
10 vlerësim të gjatësisë së çështjes së saj, apo argumenteve të
11 saj.

12 ZPS-ja kërkohet që të paraqesë në Konferencën Përgatitore
13 një vlerësim të kohëzgjatjes së argumenteve të saj.

14 Urdhri i nëntë, për shtyrjen e afatit për mocionet e
15 Mbrojtjes ndaj parashtrimeve të ZPS-së për 12 dëshmitarët e
16 parë.

17 Pasi ka dëgjuar që janë paraqitur arsye bindëse, Trupi
18 Gjykses urdhëron Mbrojtjen e përbashkët, e miraton programin -
19 - mocionin e Mbrojtjes për dosjen F01204.

20 Pala Mbrojtëse urdhërohet që të dorëzojë mocionet e saj
21 ndaj 12 dëshmitarëve të parë të ZPS-së jo më vonë se 13
22 shkurti i vitit 2023, ora 16.00.

23 Këtu përfundon Konferenca Përgatitore për Gjykimin.
24 Falënderoj palët pjesëmarrëse, Zyrën Administrative për
25 pjesëmarrjen e tyre. Po kështu falënderoj përkthyesit,

1 stenografët, teknikët audio-vizivë dhe personelin e sigurisë
2 për ndihmën e tyre. Po kështu falënderoj edhe të akuzuarit që
3 janë të pranishëm në këtë --

4 A ka gjë ndonjë gjë tjetër?

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Arsyeja
6 tjetër të cilën deshëm ta ngrinim lidhur me krimet serbe. Ne -
7 - nëse dëshironi të mos e shtyni deri në kohën e...

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë e
9 shtyjmë për herën tjetër.

10 Këtu përfundon seanca e sotme. Seanca mbyllet.

11 --- Seanca e Konferencës Përgatitore për Gjykim
12 mbyllet në orën 14.46.

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25